



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 17/34 Prot.

Tiranë më, 01/02/2024

**V E N D I M**

**Nr. 05, datë 25.01.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Bora Vrenjo**      **Kryesuese**  
**Henri Naqellari**      **Relator**  
**Loreta Hanxhari**      **Anëtare**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj, në orën 09:30, datë 25.01.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:**

**Z. Ervin Veli Hodaj**, me funksion Drejtor, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,**

pasi dëgjoi relatimin e relatorit të çështjes Henri Naqellari, dëgjoi subjektin e vlerësimit Ervin Veli Hodaj, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 12.01.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 2, nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, Z. Ervin Hodaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Me Urdhër nr. \*\*\*, datë 11.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit është transferuar dhe emëruar në detyrën e Drejtorit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. Subjekti i vlerësimit, Z. Ervin Hodaj, i’u nënshtroa procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me Vendimin Nr. 01, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, të përbërë nga: Z. Henri Naqellari Relator, Znj. Bora Vrenjo Kryesuese dhe Znj. Loreta Hanxhari Anëtare.
6. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr. 01, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj.

7. Relatori i çështjes, Z. Henri Naqellari, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit, ka njoftuar relatorin e çështjes, nëpërmjet emailit të datës 21.04.2023, duke shprehur se **nuk është** në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (këtu në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.
12. Në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 06.10.2023, (protokolluar me tonën nr. \*\*\*, prot., datë 11.10.2023), dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Z. Ervin Hodaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI, për secilën pasuri është konstatuar se:
  - Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
  - Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
  - Nuk është kryer deklarim i rremë;
  - Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
13. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 31.07.2023, ka dërguar raportin e saj për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të vlerësimit Z. Ervin Hodaj.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i vlerësimit, gjatë periudhës objekt vlerësimi, të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 30.06.2023, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konkluduar se:
- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
  - Ka aftësi në zbatim të detyrave sipas përshtatësive të punës;
  - Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.
15. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
16. Trupa e vlerësimit, më datë 11.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, me Vendimin nr. 02, datë 11.12.2023, vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj;
  - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
    - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
    - ✚ *Rezultatet e hetimit, të pasqyruara në relacionin paraprak, për të tre komponentët, të vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*
  - c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
17. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

## II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me email, në datën 09.01.2023.
19. Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën 12.01.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, në prani të sekretariatit teknik.

**20.** Subjekti i vlerësimit Z. Ervin Hodaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti kërkoi nga Trupa e Vlerësimit konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

**21.** Z. Ervin Hodaj ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**22.** Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

**23.** Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- Vlerësimin e pasurisë;
- Kontrollin e figurës;
- Vlerësimin e aftësive profesionale.

**24.** Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- Ligjin nr. 49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”;
- Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Provat dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit;
- Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit;
- Raportin e dorëzuar nga ILDKPKI;
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Deklarata e Pasurisë;
- Deklarata për Kontrollin e Figurës;

- Formulari i Vlerësimit Profesional;
- Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

25. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
26. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Ervin Hodaj**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve të përcaktuara dhe mban nr. index 01, viti 2023.
27. Procedurat e deklarimit të pasurisë, kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
28. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
29. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit, ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti, për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, në zbatim të nenit 33/1 dhe nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

### **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklarinimet e subjektit, si dhe përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

### **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;

- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme, si edhe rasteve të konfliktit të interesit.

## **Deklarimi i pasurisë**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite, deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë si më poshtë:

- Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- Pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
- Sendet me vlerë të veçantë mbi 300, 000 lekë;
- Vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- Vlerën e likuiditeteve, gjendje në kesh jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaja;

Subjekti i vlerësimit Z. Ervin Hodaj, është emëruar në detyrë, në datën 16.12.2022, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Aktualisht ushtron detyrën e Drejtorit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në deklaratën Veting, të dorëzuar në strukturat përgjegjëse, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim:

**1.** Apartament banimi me sip. 78 m<sup>2</sup>, në rr. “P. K”, nd. 8, hy.7, ap. 13, Tiranë, blerë në datë 17.08.2007. Vlera 2, 000, 000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit:

- Nga të ardhurat e mia, bashkëshortes sime, familjarëve të mi ndër vite (babai, nëna, motra të cilët deri në vitin 2010, kanë qenë në certifikatën time familjare).
- Shitja e makinës Mercedes Benz C Class 180, me targë TR\*\*\*8J, në pronësinë time me vlerë 150, 000 lekë.
- Shitja e apartamentit në rr. “N. M”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kat. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në pronësi të familjes, me vlerë 1, 950, 000 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 17.08.2007, për apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë. Blerës: Ervin Hodaj. Shitës: S.D. Çmimi: 2, 000, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 20.07.2015, për apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, rr. “I. T” (ose “P. K”), Tiranë, regjistruar në emër të Ervin Hodaj.
- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 21.06.2004, për apartament me sip. 72, 9 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë. Shitës: Veli, Bukuri, Ervin dhe Pranvera Hodaj. Blerës: L.S. Çmimi: 1, 950, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 08.04.2004, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 72, 9 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, rr. “N. M”, P. \*\*\*, Sh.\*\*\*, K.\*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë, regjistruar në emër të Veli Hodaj.
- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 16.08.2007, për automjet Mercedes Benz 180. Shitës: Ervin Hodaj. Blerës: N.M dhe G.M. Çmimi 150, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

**ASHK Tirana Jug**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.06.2023, konfirmon se në emër të Ervin Hodaj, rezulton e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*. Bashkëlidhur: Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 17.08.2007, për apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë. Blerës: Ervin Hodaj. Shitës: S.D. Çmimi 2, 000, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**UKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Ervin Hodaj, rezulton kontrata nr. \*\*\*, për objektin me adresë rr. “I. T “, me status “Aktiv”. Bashkëlidhur: Vërtetim nga dokumenti hipotekor, nr. \*\*\*, datë 24.08.2007, për apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, rr. “I. T”, Tiranë, regjistruar në emër të Ervin Hodaj.

**Intesa SanPaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, ka konfirmuar se Ervin, Veli dhe Bukuri Hodaj, në datë 31.12.2004, kanë pasur depozitë me gjendje 29, 735 dollar (në vitin 2005, gjendja e kësaj depozite është zero).

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti ka sqaruar se, duke qenë se ka jetuar bashkë me prindërit dhe motrën e vogël, deri kur ajo është martuar, të gjitha të ardhurat mbaheshin bashkë si për shpenzimet ashtu dhe për kursimet. Pas shitjes së apartamentit në rr. “Njazi Meka”, vendosën të blejnë një apartament tjetër, por duke qenë se subjekti në atë kohë ishte fejuar, vendosën të blejnë dy apartamente të vogla, njëri 78 m<sup>2</sup> (në pronësi të subjektit) dhe tjetri 69 m<sup>2</sup> (në pronësi të babait dhe nënës, ku jetojnë edhe aktualisht).

Kështu në vitin 2007, janë blerë dy apartamente në rr. “P. K”, për shumën 4, 000, 000 lekë, (2, 000, 000 lekë njëri dhe 2, 000, 000 lekë apartamenti tjetër). Depozita në Intesa SanPaolo Bank në shumën 29, 735 dollar, është krijuar nga shuma prej 1, 950, 000 lekë, e përfutuar nga shitja e apartamentit në rr. “N. M”, si dhe nga të ardhurat dhe kursimet nga të gjithë pjesëtarët e familjes. Kjo shumë është përdorur për të blerë dy apartamentet në rr. “P. K”, apartamentin që aktualisht është në pronësinë e subjektit, si dhe apartamentin që është në pronësi të babait të tij, ku aktualisht jeton së bashku me nënën, apartament i cili ndodhet po në të njëjtën adresë.



Lidhur me bashkëjetesën me bashkëshorten e tij, subjekti deklaron se ajo ka nisur në fund të vitit 2005. Nga viti 2004, kohë kur kanë shitur apartamentin në rr. “N. M” Tiranë, deri kur është blerë apartamenti në rr. “P. K”, subjekti dhe familja kanë jetuar me qira në një apartament në të njëjtin pallat, në rr. “N. M”, por nuk disponon kontratë të qirasë së këtij apartamenti.

Për burimin financiar të familjarëve të tij, subjekti shpjegoi se prindërit e tij kanë qenë gjithmonë në marrëdhënie pune. Babai me profesion mësues, ka punuar në fshatin Nivicë, Tepelenë, si mësues, para viteve ‘90. Në vitet 1990 – 1992, ka qenë drejtor i shkollës së mesme në këtë fshat. Më pas, në vitet 1992 – 1996, është zgjedhur si Kryetar Komune në Kurvelesh, Tepelenë. Pasi ka mbarur mandatin, është transferuar në Tiranë dhe ka punuar si mësues në shkollën “Ramazan Jarani”, Tiranë, deri në vitin 2005, vit kur doli dhe në pension.

Nëna me profesion infermiere, ka punuar para viteve 1990 deri në vitin 1997, në fshatin Nivicë, Tepelenë. Pas këtij viti, deri në vitin 2014 (vit kur ka dalë në pension), ka punuar si infermiere në Spitalin Pediatrik në QSUT, Tiranë. Motra Pranvera Elezaj, ka mbaruar shkollën e lartë për ekonomik, dhe nga data 01 prill 2003 deri në dhjetor 2008, ka punuar si ekonomiste në kompaninë “\*\*\*\*” sh.p.k. Prindërit dhe motra (deri në momentin kur është martuar), kanë jetuar dhe jetojnë aktualisht në apartamentin në rr. “P. K”, e cila ndodhet në të njëjtin kat me apartamentin në pronësinë të subjektit.

Për blerjen e apartamentit të mëparshëm në rr. “N. M”, (i cili më pas u shit 1, 950, 000 lekë), subjekti shpjegoi se ai është blerë rreth vitit 1998, por nga koha e largët që ka kaluar, nuk ka kujtesë për çmimin e blerjes së tij. Burimi financiar për blerjen e tij, ka qenë nga shitja e një apartamenti tjetër në Babrru, Tiranë, në pronësi të babait, blerë prej tij rreth vitit 1995, me të ardhurat familjare, por edhe për këtë apartament, nisur nga koha e largët, është objektivisht e pamundur të disponohen dokumente.

Lidhur me faktin se adresa në rr. “N. M”, është deklaruar prej tij në deklaratat periodike vjetore ndër vite, edhe pas shitjes së tij, subjekti shpjegoi se në formularin e DPF/2013 kërkohej adresa ku ishte regjistruar në gjendjen civile, si dhe adresa e vendqëndrimit dhe deri në kohën që ka plotësuar DPF/2013, nuk e kishte ndryshuar ende gjendjen civile dhe figuronte në adresën e apartamentit në rr. “N. M”, ndërkohë ka plotësuar edhe adresën e vendbanimit, ku banonte në atë vit, në rr. “P. K”. Lidhur me mobilimin e apartamentit në rr. “P. K”, subjekti shpjegoi se e ka mobiluar në një mobileri në afërsi të restorant “D\*\*\*\*”, nuk ka të dhëna më të hollësishme edhe për shkak të kalimit të viteve. Mobilimi duhet të ketë kushtuar rreth 250, 000 lekë ose 300, 000 lekë, por nuk disponon fatura.

### **Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin ligjor me qëllim justifikimin e burimeve për blerjen e pasurisë, konkretisht:**

- Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 15.06.2020, lëshuar nga ISSH, ku vërteton se Veli Hodaj, trajtohet me pension pleqërie, me masë mujore 30, 111 lekë, gjithashtu ai është trajtuar edhe me pension invaliditeti, në masën 44, 755 lekë. Të ardhurat nga pensioni, për periudhën 19.11.2005 - 31.05.2020, janë në shumën 4, 120, 657 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme, lëshuar nga Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, ku vërteton se Bukuri Hodaj, për periudhën 1997 - 2014, ka përfutuar të ardhura neto nga pagat, në shumën 4, 360, 635 lekë.
- Vërtetim, datë 12.06.2020, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila vërteton se Pranvera Elezaj, për periudhën 2003 - 2008, ka përfutuar të ardhura në shumën 1, 162, 800 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, nga ku janë konstatuar pasaktësi të dhënash të pasqyruara në aktet noteriale, konkretisht:

- Në deklaratën e pasurisë, subjekti deklaron apartament banimi me sip. 78 m<sup>2</sup>, në rr. “P.K”, nd. 8, h.7, ap.13, Tiranë, ndërkohë që në kontratën e shitblerjes datë 17.08.2007, rezulton adresa rr. “I. T” dhe numri i apartamentit 10 dhe jo 13, siç është deklaruar.
- Në kontratën e qirasë më datë 02.12.2020, lidhur ndërmjet Iris Hodaj (bashkëshjortja e subjektit) dhe M. C, evidentohet fakti se objekti i kontratës është apartament 2+1, në adresën rr. “P. K”, nd. 8, h. 7, ap. 5, Tiranë. Konstatohet se nuk korrespondon numri i apartamentit të deklaruar në deklaratën e pasurisë (ap.13), me numrin e apartamentit objekt i kësaj kontrate.
- Në kontratën e qirasë më datë 02.02.2022, lidhur ndërmjet Iris Hodaj dhe O/E. B, evidentohet fakti se objekti i kontratës është apartament 2+1, me sip. 80 m<sup>2</sup>, në adresën V. Sh, rr. “P. K”, Tiranë. Konstatohet se nuk korrespondon sipërfaqja e apartamentit të deklaruar nga ana juaj në deklaratën e pasurisë (78 m<sup>2</sup>), me sipërfaqen e apartamentit objekt i kësaj kontrate.
- Në dokumentet: Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, datë 12.11.2021 dhe datë 24.11.2021, Kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme, datë 21.12.2021 dhe datë 14.06.2022, adresa e banimit të Iris Hodaj, rezulton rr “P. K”, nd. 22, h.2, ap.10. Të dhënat e mësipërme nuk korrespondojnë me të dhënat e deklaruara në deklaratën e pasurisë dhe të dhënat e pasqyruara në certifikatën e pronësisë, të dorëzuar nga subjekti për këtë apartament, sa i përket numrit të ndërtesës (22) dhe numrit të hyrjes (2).
- Në dokumentet e vëna në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, adresa e banimit për Iris Hodaj, është adresa e deklaruar në deklaratën e pasurisë, konkretisht rr. “P. K”, nd. 8, h. 7, ap. 13, ç’ka nuk përputhet me të dhënat e deklaruara në kontratën e shitblerjes për këtë apartament.

Sa më sipër subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse, duke u shprehur se: “...Adresa e apartamentit në kontratën e shitblerjes datë 17.08.2007, rezulton adresa rr. “I. T”, sepse kjo adresë ka qenë në kohën e bërjes së kësaj kontrate shitblerjeje. Më pas nga ana e Njësisë Bashkiake nr.5, janë bërë disa herë ndryshime dhe saktësime adresash. Në momentin kur unë jam bërë subjekt deklarimi pasurie në vitin 2013, ka qenë adresa e dhënë në këtë deklaram. Kjo është adresa që ne përdorim edhe aktualisht.

Mospërputhja e adresave vjen për faktin se, Njësia Administrative disa herë ka sjellë saktësim adresash dhe zyrtarisht si adresë ka mbetur ajo e deklaruar në deklaratën e pasurisë, e cila përputhet me atë që ne kemi edhe në platformën e-Albania.

Për sa i përket mospërputhjes së sipërfaqes në kontratat e qirasë, theksoj se këto kontrata janë lidhur pranë zyrave të agjencive imobiliare, të cilët kanë përpiluar kontratën e qirasë. Nga ana ime dhe e bashkëshortes, nuk i është kushtuar vëmendja apo rëndësia e duhur për sipërfaqen apo adresën e vënë nga ana e tyre.

Pra, theksoj në përgjegjësinë time, se apartamenti në pronësinë time, ka adresën e banimit të deklaruar në deklaratën e pasurisë konkretisht, apartament 78 m<sup>2</sup>, rr. “P. K”, nd. 8, h. 7, ap. 13,

*e cila përputhet edhe me adresën tonë në platformën e-Albania, dhe është i njëjti që kemi dhënë me qira prej vitesh sipas kontratave që ju keni përmendur...”*

Në funksion të hetimit administrativ, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin përkatës lidhur me apartamentin e mësipërm, administruar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- **Kartela e pasurisë së paluajtshme**, me kod \*\*\*, në të cilën pasqyrohen të dhënat si më poshtë:

Të dhënat e pasurisë: Zona kadastrale nr. \*\*\*, lloji i pasurisë apartament, nr. i pasurisë \*\*\*, sipërfaqja totale 78 m<sup>2</sup>.

Të dhënat e titullit të pronësisë: Pronari: Ervin Veli Hodaj, nr. identifikimi \*\*\*, pjesa takuese 1/1, regjistruar me nr. \*\*\*, datë 24.08.2007.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Apartamenti me sip. 78 m<sup>2</sup>, në rr. “P. K”, Tiranë, është blerë në vitin 2007, me vlerë 2, 000, 000 lekë, me burim pjesërisht të ardhura nga shitja e apartamentit të mëparshëm në bashkëpronësi me prindërit, në vitin 2004, si dhe të ardhura të familjarëve të tij, me të cilët ka bashkëjetuar, deri në blerjen e apartamentit.*
  - *Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e apartamentit, me sip. 78 m<sup>2</sup>, në rr. “P. K” Tiranë, në vitin 2007.*
  - *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjet e ASHK, UKT Tiranë, dhe Intesa SanPaolo Bank.*
  - *Pasuria e trajtuar më sipër, është krijuar më datë 17.08.2007, dhe ndodhur në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, Trupa e Vlerësimit nuk i është nënshtruar procedurave hetimore me qëllim konstatimin e faktit, nëse subjekti i vlerësimit e justifikon apo jo ligjshmërinë e burimit të krijimit për këtë pasuri.*
- 2.** Depozitë bankare në Credins Bank. Vlera 1, 644, 741 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes.
- Shuma prej 700, 000 lekë, ka qenë Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë, deri në vitin 2015. Në shkurt 2015, kësaj shume i është shtuar shuma 474, 500 lekë, nga kursimet familjare dhe është futur me afat dy vjeçar.
  - Në shkurt 2018, interesat e fituara nga kjo llogari janë rreth 61, 000 lekë.
  - Në shkurt 2020, interesat e fituara nga kjo llogari janë rreth 53, 077 lekë, shtuar shumës në total.
  - Në shkurt 2022, interesat e fituara nga kjo llogari janë rreth 44, 989 lekë, shtuar shumës në total.

## **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për depozitën bankare të deklaruar nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit e konkretisht:

**Banka e Shqipërisë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj, në periudhën 22.04.2008 - 27.09.2012, ka pasur Bono Thesari në shumën 400, 000 lekë, ndërsa për periudhën 27.09.2012 - 25.12.2014, ka pasur Bono Thesari në shumën 700, 000 lekë.

**OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj, në datë 10.04.2008 (në Alpha Bank), ka derdhur në llogari një shumë prej 400, 000 lekë, të cilat i ka investuar Bono Thesari.

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje të llogarive në emër të Ervin Hodaj, ku evidentohet se më datë 18.09.2012 subjekti ka depozituar pranë kësaj banke vlerën 300, 000 lekë, me objekt “Shtim në depozitë”.

Sa i përket këtij fakti, subjekti është shprehur se: *“Ndër vite, nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, kemi patur një shumë prej 400, 000 lekë, të cilat i kemi depozituar si Bono Thesari pranë Bankës së Shqipërisë, si i vetmi institucion financiar që shiste Bono Thesari. Në vitin 2012, vendosëm të shtonim si Bono Thesari dhe 300, 000 lekë të kursyera deri në këtë vit. Duke qenë se Banka e Shqipërisë nuk është bankë e nivelit të dytë dhe nuk mund të pranonte para të depozituara drejtpërdrejtë nga klienti, nga ana ime shuma prej 300, 000 lekë, u depozitua një herë në bankën e nivelit të dytë “Tirana Bank”, me qëllim kalimin pastaj te Banka e Shqipërisë për blerje Bono Thesari. Pra, kjo shumë është transferuar në Bankën e Shqipërisë dhe ju bashkua shumës prej 400, 000 lekë që kisha në Bono Thesari.*

*Në vitin 2015, për shkak të interesave të ulta, unë i shita këto Bono Thesari dhe shuma u transferua në bankën e Credins Bank, shumë që më pas u shtua dhe me kursime të tjera dhe aktualisht janë si depozitë në llogarinë time në këtë bankë. (E përmendur në deklaratimet e pasurisë ndër vite)...”*

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj, më datë 16.02.2015, ka hapur një depozitë në vlerën 1, 001, 000 lekë, e cila është krijuar nga kursimet në Bono Thesar në vlerën 700, 000 lekë, dhe depozitim i vlerës prej 300, 000 lekë më datë 05.02.2015. Depozita është shtuar më datë 16.02.2016 me 474, 500 lekë. Gjendja e kësaj depozite në datë 27.02.2023, duke shtuar dhe interesat e fituara, është në vlerën 1, 644, 741 lekë.

Trupa e Vlerësimit, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 1, 644, 741 lekë në periudhën 2008 - 2022, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

## **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ***Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me përgjigjet e institucioneve bankare.***

- **Subjekti i vlerësimit, referuar analizës financiare, ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim kursimin e shumës prej 1, 644, 741 lekë përgjatë periudhës 2008 – 2022.**
- 3.** Llogari page në Credins Bank. Data e balancës 01.03.2023. Vlera 4, 123 lekë. Zotërimi 100%. Paga si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj në datë 27.02.2023, ka llogari page me gjendje 4, 123 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

- 4.** Llogari kartë krediti në Credins Bank. Data e balancës 01.03.2022. Vlera 334 euro. Vlera e overdraftit 1, 000 euro. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj, në datë 27.02.2023, ka llogari MasterCard World, me gjendje -675 euro.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së kartës së kreditit të subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

- 5.** Fonde Investimi (Pension) në Credins Invest. Vlera 44, 428 lekë. Zotërimi 100%. Shuma e investuar: 0. Norma e interesit: 3, 47 %. Data e lançimit të fondit: 01.08.2019. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj, në datë 27.02.2023, ka kuota në Fondin e Pensionit, me balancë 45, 667 lekë.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 44, 428 lekë nëpërmjet Credins Bank, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

#### **Konkluzion:**

- **Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me përgjigjet e institucioneve bankare.**
- **Subjekti i vlerësimit, referuar analizës financiare, ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim kursimin shumës prej 44, 428 lekë.**

**Pasuria nr. 6:** Automjet Mercedes Benz 180 C Class, viti i prodhimit 1993, blerë në vitin 2004, shitur në vitin 2007, me vlerë 150, 000 lekë, shtetasit G. M.

### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 16.08.2007, për automjet Mercedes Benz 180. Shitës: Ervin Hodaj. Blerës: N. M dhe G. M. Çmimi 150, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetit e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur me të.

Nëpërmjet postës elektronike të datës 19.06.2023, ka bashkëlidhur dosjen e automjetit me targa TR \*\*\*8 J:

- Faturë blerje (italisht), për automjet Mercedes Benz. Blerës: Ervin Hodaj. Çmimi: 2, 270 euro. Deklaratë doganore, datë 09.02.2004, për automjet Mercedes Benz, me shumë të faturuar 2, 270 euro, e konvertuar në vlerën 301, 955 lekë. Importues: Ervin Hodaj.
- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 16.08.2007, për automjet Mercedes Benz 180. Shitës: Ervin Hodaj. Blerës: N. M dhe G. M. Çmimi 150, 000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se ky automjet është blerë në vitin 2004, në shumën 2, 270 euro, me kursimet familjare dhe përdorej nga të gjithë pjesëtarët e familjes në ato vite, për të gjitha shërbimet dhe nevojat e familjes.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- *Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me përgjigjet e DPSHTRR.*
- *Pasuria e trajtuar më sipër është krijuar në vitin 2004, dhe ndodhur në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, Trupa e Vlerësimit nuk i është nënshtruar procedurave hetimore me qëllim konstatimin e faktit, nëse subjekti i vlerësimit e justifikon apo jo ligjshmërinë e burimit të krijimit për këtë pasuri.*

### **Deklarimi i të ardhurave financiare ndër vite të subjektit të vlerësimit**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/b, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaroi të ardhurat nga paga, nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike, me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie të kryer brenda dhe jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta, që sjellin

fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të Policisë Vendore Shkodër, nga data 23.12.2022, deri në datë 01.03.2023, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 24.02.2023, të marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër. Shuma 256, 657 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Sektorit të Planifikimit dhe Kurikulave dhe profesor në Fakultetin e Hetimit dhe të Sigurisë, në Akademinë e Sigurisë nga data 01.05.2017 deri në datë 23.12.2022, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 16.02.2023, të marrë nga Akademia e Sigurisë. Shuma 6, 269, 735 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nga data 28.04.2015 deri në datë 27.04.2017, sipas të dhënave të dërguara nga Credins Bank në datë 14.04.2018. Shuma 3, 421, 545 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nga data 09.10.2013 deri në datë 27.04.2015, sipas të dhënave të dërguara nga Credins Bank në datë 10.04.2018 dhe të dhënave nga Tirana Bank, printuar në datë 10.04.2018. Shuma 1, 733, 037 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i specialistit të Sektorit të Hetimit në Mbulim, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, nga data 25.08.2011 deri në 08.10.2013, sipas të dhënave të marra nga Tirana Bank, printuar në datë 10.04.2018. Shuma 3, 365, 736 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i specialistit të Sektorit Kundër Narkotikëve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga data 20.02.2006 deri në datë 24.08.2011, sipas të dhënave të marra nga Tirana Bank, printuar në datë 10.04.2018 dhe të dhënave të marra nga Raiffeisen Bank, printuar në datë 10.04.2018. Shuma 4, 839, 264 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Seksionit Kundër Narkotikëve, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, nga data 01.10.2005 deri në datë 19.02.2006, sipas të dhënave të vërtetimit nr. \*\*\*, datë 12.04.2018, i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Shuma 213, 011 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i Shefit të Seksionit të Policisë Kriminale, në Komisaratin e Policisë Fier dhe Lushnjë, nga data 02.05.2002 deri në datë 30.09.2005, sipas të dhënave nga vërtetimi nr. \*\*\*, datë 11.04.2018, i Drejtorisë Vendore të Policisë Fier. Shuma 1, 374, 234 lekë.
- ❖ Të ardhura nga funksioni i inspektorit të Policisë Kriminale, në Komisaratin e Policisë nr. 1, Tiranë, nga data 01.07.2000 deri në datë 30.04.2002, sipas të dhënave të vërtetimit nr. \*\*\*, datë 12.04.2018, i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Shuma 241, 718 lekë.
- ❖ Interesa të fituara nga depozita bankare në Credins Bank, me afat 2-vjeçar. Në shkurt 2018, interesat e fituara nga kjo llogari, janë rreth 61, 000 lekë. Në shkurt 2020, interesat e fituara nga kjo llogari, janë rreth 53, 077 lekë. Në shkurt 2022, interesat e fituara nga kjo llogari, janë rreth 44, 989 lekë, shtuar shumës në total. Shuma 159, 066 lekë.
- ❖ Të ardhura nga qiraja e apartamentit në pronësinë time, në adresën rr. “P. K”, nd. 8, shk. 2, ap. 13, h. 7, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë për periudhat:
- ❖ 01.02.2019 - 31.01.2020, kontratë qiraje lidhur më 28.01.2019, me agjencinë InfoExpress, me shtetasit D. Sh dhe T. S, sipas termave të përcaktuara në kontratë. Kontrata ka vazhduar edhe pas përfundimit deri me datë 31.10.2020, për shkak të pandemisë Covid-19 veprimet kanë vazhduar pa lidhje kontrate. Shuma 6, 300 euro.

- ❖ 01.12.2020 - 30.11.2021, kontratë qiraje me shtetasen M. Ç, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratë, me një çmim prej 330 euro në muaj. Kjo kontratë ka vazhduar deri më datë 31.01.2022. Shuma 4, 620 euro.
- ❖ 05.02.2022 - 13.12.2022, kontratë qiraje lidhur mes shtetasit O. B dhe E. B, ndërmjetësuar nga agjencia imobiliare \*\*\*, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratë. Shuma 4, 800 euro.

Tatim i mbajtur në burim për dhënien me qira të apartamentit, sipas kontratave më lartë. Palës që i detyrohet: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, konkretisht:

- Periudha 2019 - 2020 - 64, 800 lekë.
- Periudha 2020 - 2022 - 149, 969 lekë.
- Periudha shkurt 2022 - dhjetor 2022 - 94, 769 lekë.

Sipas urdhër pagesave të lëshuara për këtë qëllim nga organi kompetent tatimor.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.02.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, i cili vërteton se Ervin Hodaj, për periudhën 23.12.2022 - 01.03.2023, ka përfituar të ardhura neto, në shumën 256, 657 lekë.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 12.04.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohet se Ervin Hodaj, për periudhën 01.07.2000 - 30.04.2002; 01.10.2005 - 19.02.2006 dhe 28.04.2015 - 27.04.2017, ka përfituar të ardhura neto në shumën 3, 297, 307 lekë (për periudhën 01.07.2000 - 30.04.2002, ka përfituar 241, 718 lekë).
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.04.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku vërtetohet se Ervin Hodaj, për periudhën 30.09.2002 - 30.09.2005, ka përfituar të ardhura neto në shumën 1, 374, 234 lekë (për periudhën 30.09.2002 - 02.03.2005, i janë përlllogaritur të ardhura në shumën 1, 107, 017 lekë).
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për veprimet në llogarinë e Ervin Hodaj për periudhën 03.03.2005 - 20.01.2012.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për veprimet në llogarinë e Ervin Hodaj për periudhën 06.01.2011 - 15.12.2014.
- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për veprimet në llogarinë e Ervin Hodaj për periudhën 03.12.2014 - 06.04.2018.
- Kontratë qiraje, datë 28.01.2019, për apartament në rr. "P. K", Tiranë. Qiradhënës: Ervin Hodaj. Qiramarrës: D. Sh dhe T. S. Qiraja: 300 euro/muaj, do të paguhet në llogarinë e shtetasës Pranvera Elezaj. Afati: 01.02.2019 - 31.01.2020. Tatimi për qiranë mujore do të paguhet nga qiradhënësi.
- Kontratë qiraje, datë 02.12.2020, për apartament në rr. "P. K", Tiranë. Qiradhënës: Iris Hodaj. Qiramarrës: M. C. Qiraja: 330 euro/muaj. Afati: 12 muaj, duke nisur nga data 01.12.2020. Qiramarrësi është i detyruar të paguajë çdo detyrim që lind nga kjo kontratë, si energji elektrike, uji, administrim, etj.
- Kontratë qiraje, datë 02.02.2022, për apartament në rr. "P. K", Tiranë. Qiradhënës: Ervin Hodaj. Qiramarrës: O. B dhe E. B. Qiraja: 400 euro/muaj do të derdhet në llogarinë e Pranvera Elezaj. Afati: 05.02.2022 - 04.12.2023. Me mbarimin e afatit palët mund të rinovojnë kontratën.
- Urdhër pagesë, datë 30.12.2022, për tatimin e mbajtur në burim, për Iris Hodaj, për periudhën mars 2020, në shumën 149, 969 lekë.



- Urdhër pagesë, datë 30.12.2022, për tatimin e mbajtur në burim, për Iris Hodaj për periudhën shkurt 2022, në shumën 94,769 lekë.
- Vërtetim page nr. \*\*\* prot, datë 16.02.2023, lëshuar nga Akademia e Sigurisë, për të ardhurat e Ervin Hodaj, për periudhën 01.05.2017 - 23.12.2022, në shumën 6, 269, 735 lekë.

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse konkretisht:

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrjet e llogarive në emër të Ervin Hodaj, ku evidentohet se për periudhën 03.03.2005 - 31.12.2010, ka përfituar të ardhura nga paga, dieta, shpërblime etj., në shumën 4, 940, 746 lekë.

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje të llogarive në emër të Ervin Hodaj, ku evidentohet se për periudhën 01.01.2011 - 31.12.2011 dhe 01.01.2013 - 04.11.2014, ka përfituar të ardhura nga paga, dieta, shpërblime etj., në shumën 3, 766, 384 lekë (për periudhën 01.01.2012 - 31. 12.2012, të ardhurat janë përlllogaritur, sipas nxjerrjes së llogarive që ka paraqitur vetë subjekti, në shumën 1, 437, 782 lekë).

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrjet e llogarive në emër të Ervin Hodaj, ku evidentohet se për periudhën 03.12.2014 - 27.02.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, dieta, shpërblime etj., në shumën 10, 672, 453 Lekë. Gjithashtu në vitin 2019, ka përfituar edhe 808 euro nga Frontex dhe për periudhën 2015 - 2022, ka përfituar interesa neto nga depozita në shumën 169, 241 lekë.

**ISSH**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, për periudhën nga viti 2012, disponon të dhëna në sistemin informatik, dhe konfirmon se Ervin Hodaj për periudhën dhjetor 2012 - shkurt 2023, ka të dhëna punësimi, ku ka përfituar të ardhura në institucionet: Drejtoria e Forcës së Posaçme, Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, Drejtoria Vendore e Policisë Fier, Drejtoria e Policisë, Akademia e Sigurisë, dhe Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

**DRT Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, konfirmon se nga shtetasi Ervin Hodaj, për kontratën e qirasë, datë 28.01.2019, nuk ka pagesa të kryera për tatimin në burim, për periudhën 01.02.2019 - 31.01.2020. Për kontratën e qirasë, datë 02.12.2020, nga ana e shtetases Iris Hodaj është kryer deklarim dhe pagesë për tatimin në burim si vijon:

<b>Periudha e deklarimit</b>	<b>Qiraja</b>	<b>Paguar tatim mbi qiranë</b>
2020/02	432, 000 lekë	64, 800 lekë
2020/03	705,600 lekë	105, 840 lekë

- Për kontratën e qirasë, datë 31.12.2019, nuk është kryer deklarim dhe pagesë për tatimin në burim.
- Për kontratën e qirasë, datë 02.02.2022, nuk është kryer deklarim dhe pagesë për tatimin në burim.

- Për kontratën e qirasë, datë 13.12.2022, nuk është kryer deklarin dhe pagesë për tatimin në burim.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se më datë 13.12.2022, është lidhur kontratë 5 vjeçare qiraje, me nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, ndërmjet bashkëshortes Iris Hodaj dhe motrës Pranvera Elezaj. Për këtë kontratë është përcaktuar pagesa e qirasë prej 180 euro në muaj.

Ndërkohë subjekti, me prokurë të posaçme nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, i ka lënë në administrim, përdorim apo qira, apartamentin në rr. “P. K”, motrës Pranvera Elezaj. Pra, nga akti noterial, vlera e kontratës është vetëm 180 euro në muaj, dhe detyrimi është vetëm për këtë vlerë. Apartamenti në rr. “P. K”, i lënë me prokurë në administrim znj. Pranvera Elezaj, është jashtë vlerës së kësaj kontrate qiraje. Pagesat e detyrimeve tatimore janë bërë nga ana e bashkëshortes pasi, që në kontratën e parë të dhënies me qira të datës 28.01.2019, është përcaktuar që qiradhënësi do të paguajë në organet tatimore 15% të tatimit të mbajtur në burim. Në këtë rrjedhë kanë vazhduar edhe pagesat për dy kontratat e tjera. Kjo është arsyeja pse për periudhën 2019 - 2022, tatimi në burim është paguar nga bashkëshortja në cilësinë e qiradhënësit.

Për të tre kontratat e qirasë, të lidhura për apartamentin në rr. “P. K”, nga periudha shkurt 2019 - shkurt 2023, është paguar nga ana e bashkëshortes për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, tatimi i mbajtur në burim. Pagesa është bërë me tre derdhje bankare në Raiffeisen Bank, në periudha të ndryshme kohore, që mbulojnë të gjithë periudhën e dhënies së apartamentit me qira, në shumat si më poshtë:

- ✓ Më datë 04.03.2020, është paguar 64, 800 lekë, pagesë që mbulon kontratën e parë të qirasë;
- ✓ Më datë 30.12.2022, janë paguar dy urdhër pagesa, që mbulojnë të dy kontratat e tjera të qirasë: në shumën 149, 969 lekë dhe 94, 769 lekë.

Në shumat e mësipërme, janë përfshirë edhe gjobat për deklarin të vonuar. Këto shuma janë paguar nga kursimet familjare dhe 1, 000 euro tërhequr nga llogaria e bashkëshortes në Raiffeisen Bank. Bashkëlidhur, urdhër pagesat për këto periudha dhe tërheqja/derdhja nga llogaria e bashkëshortes në Raiffeisen Bank.

Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për apartamentin e motrës së marrë me qira nga ana e tij, subjekti shpjegoi se, sipas kontratës, detyrimi për të paguar tatimet është i qiradhënësit (motrës), pasi edhe ligji detyron përfituesin e të ardhurave të mbajë dhe të paguajë tatimin në burim.

#### **Bashkëlidhur shpjegimeve, në funksion të hetimit administrativ subjekti ka dorëzuar:**

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të Pranvera Elezaj, ku për periudhën 2019 - 2022, evidentohen pagesa qiraje nga shtetas të tjerë dhe konkretisht: për vitin 2019, shuma 4, 414 euro; për vitin 2020, shuma 5, 585 euro; për vitin 2021, shuma 2, 970 euro; për vitin 2022, shuma 4, 800 euro dhe për vitin 2023, deri në datë 27.02.2023, shuma 360 euro.
- Urdhër pagesë, datë 04.03.2020, në emër të Iris Hodaj, me anë të të cilit është paguar tatim mbi qiranë, në shumën 64, 800 lekë.
- Urdhër pagesë, datë 30.12.2022, në emër të Iris Hodaj, me anë të të cilit është paguar tatim mbi qiranë, në shumën 149, 969 lekë.
- Urdhër pagesë, datë 30.12.2022, në emër të Iris Hodaj, me anë të të cilit është paguar tatim mbi qiranë, në shumën 94, 769 lekë.

- Mandat tërheqje nga llogaria në Raiffeisen Bank, në emër të Iris Hodaj, ku evidentohet se në datë 30.12.2022, është tërhequr një shumë prej 1, 000 euro.
- Mandat këmbimi valutor në Raiffeisen Bank, në emër të Iris Hodaj, ku evidentohet se më datë 30.12.2022, ka këmbyer një shumë prej 900 euro, në vlerën 100, 800 lekë.
- Prokurë e posaçme nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, lëshuar nga Ervin Hodaj, me anë të së cilës, cakton si përfaqësuese ligjore, motrën e tij, Pranvera Elezaj, për të lidhur kontratë qiraje për apartamentin në pronësi të tij në rr. "I. T", Tiranë. Vlera e qirasë mujore, që do të përfitohet nga dhënia me qira e këtij apartamenti, do të kalojë çdo muaj në llogarinë e përfaqësueses ligjore Pranvera Elezaj.

### **Konkluzion:**

- *Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblimet, dietat etj., për periudhën korrik 2000 - shkurt 2023, janë në shumën rreth 22, 166, 000 lekë dhe 808 euro, konvertuar në total rreth 22, 259, 000 lekë.*
- *Gjithashtu, për periudhën deri në shkurt 2023, subjekti ka përfituar edhe interesa bankare në shumën rreth 169, 000 lekë.*
- *Subjekti, për periudhën 2019 - 2023, referuar nxjerrjes së llogarive të paraqitura, ka përfituar të ardhura nga qiraja e apartamentit në pronësi të tij, në shumën rreth 18, 129 euro, të ardhura të cilat kanë shërbyer dhe janë transferuar tërësisht nga qiramarrësit, për të paguar qiranë për apartamentin që subjekti ka marrë me qira nga motra e tij. Për të ardhurat nga qiraja, subjekti ka paguar detyrimet e tatimit në burim, në shumën rreth 310, 000 lekë.*

### **Deklarimi i detyrimeve financiare të subjektit të vlerësimit**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/c, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve, etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar detyrimet financiare si më poshtë:

- 1.** Llogari kartë krediti. Balanca 334 euro. Vlera e overdraftit 1, 000 euro. Shuma e detyrimit financiar: 665 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj në datë 27.02.2023, ka llogari MasterCard World me gjendje -675 euro.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së kartës së kreditit të subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezultoi se, **deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Credins Bank.**

**2.** Kontratë 5-vjeçare për marrje me qira apartament nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, në shumën totale 10, 800 euro, kësti mujor 180 euro, plus lënia me akt noterial, në administrim, përdorim me qira, të apartamentit në pronësinë time në rr. “P. K”, shtetases Pranvera Elezaj (motra). Është paguar shuma prej 360 euro si detyrim për muajt janar dhe shkurt 2023. Shuma e detyrimit financiar: 10, 440 euro.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 23.12.2019, lëshuar nga Ervin Hodaj, Iris Hodaj dhe Pranvera Elezaj, të cilët deklarojnë se, duke filluar nga data 28.01.2019, kanë krijuar një marrëdhënie juridiko-civile, kundrejt pagesës prej 400 euro nga Ervin dhe Iris Hodaj, për apartamentin në rr. “H. K”, Tiranë, në pronësi të Pranvera Elezaj.
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 30.12.2022, lëshuar nga Iris Hodaj, Ervin Hodaj dhe Pranvera Hodaj.
- Kontratë qiraje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 31.12.2019, për apartament në rr. “H. K”, Tiranë. Qiradhënës: Pranvera Elezaj. Qiramarrës: Iris Hodaj. Qiraja: 400 euro/muaj. Afati: 07.12.2019 - 06.12.2020. Me përfundimin e afatit, qiramarrësi detyrohet të dorëzojë ambientin. Palët me vullnet të dyanshëm mund të rilidhin kontratën.
- Kontratë qiraje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, për apartament në rr. “H. K”, Tiranë. Qiradhënës: Pranvera Elezaj. Qiramarrës: Iris Hodaj. Qiraja: 180 euro/muaj dhe qiradhënësja merr përsipër të paguajë detyrimin fiskal të tatimit në burim. Afati 13.12.2022 - 13.12.2027. Me përfundimin e afatit, qiramarrësi duhet të dorëzojë apartamentin.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrjet e llogarive në emër të Ervin Hodaj, ku evidentohet se për periudhën 29.03.2019 - 12.09.2019, ka paguar 764 euro, për pagesë qiraje në llogarinë e Pranvera Elezaj.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaron se më datë 28 janar 2019, është lidhur kontrata e qirasë ndërmjet tij dhe qiramarrësve D. Sh dhe T. S, për periudhën 01.02.2019 - 31.01.2020. Kontrata ka vazhduar edhe pas përfundimit të saj, deri më datë 31.10.2020, (për shkak të pandemisë Covid-19 veprimet kanë vazhduar pa lidhje kontrate). Më datë 02 dhjetor 2020, është lidhur kontratë qiraje mes bashkëshortes dhe shtetases M. Ç, për periudhën 01.12.2020 - 30.11.2021. Kjo kontratë ka vazhduar deri më datë 31.01.2022. Më datë 02 shkurt 2022, është lidhur kontratë qiraje mes bashkëshortes së subjektit dhe shtetasve O. B dhe E. B, për periudhën 05.02.2022 - 04.02.2023.

Në të tre këto kontrata, në nenin që flitet për mënyrën e pagesës, është vendosur se shumën e qirasë, qiramarrësit ta derdhin në llogarinë e znj. Pranvera Elezaj, në Credins Bank. Kjo është bërë me qëllim shlyerjen e pagesës së qirasë, për apartamentin e marrë me qira nga subjekti, motrës së tij Pranvera Elezaj, ndodhur në rr. “H. K”. Për periudhën 01.02.2019 - 31.10.2020, pagesa e qirasë është shlyer 100 euro në muaj nga ana subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe 300 euro në muaj nga qiraja e apartamentit të dhënë në rr. “P. K”; për periudhën 01.12.2020 - 31.01.2022, pagesa e qirasë është shlyer 70 euro nga ana e subjektit dhe bashkëshortes dhe 330 euro nga qiraja e apartamentit të dhënë në rr. “P. K”; për periudhën 05.02.2022 - 04.02.2023, pagesa e qirasë është shlyer vetëm

nga qiraja e apartamentit në rr. “P. K”, të derdhura të gjitha në llogarinë e Pranvera Elezaj në Credins Bank.

Për periudhën 2019 – 2022, për shkak të marrëdhënies së veçantë motër - vëlla, dhe duke marrë shkas që kohëzgjatja e qirasë fillestare ishte më e vogël se 1 vit, ndërmjet subjektit dhe motrës nuk është lidhur kontratë e re qiraje. Kontrata e qirasë ka vazhduar me vullnet të lirë në heshtje dhe qiraja është shlyer sipas pagesave të qirasë mujore cash dhe nëpërmjet bankës. Kjo periudhë është rregulluar me deklaratën noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, të datës 30.12.2022, ndërmjet subjektit, bashkëshortes dhe motrës Pranvera Elezaj,

Për sa i përket kontratës së qirasë të lidhur ndërmjet bashkëshortes dhe shtetasve O. B dhe E. B, për periudhën 05.02.2022 - 04.02.2023, kjo kontratë nuk është rinovuar më. Apartamenti në rr. “P. K”, i është dhënë motrës Pranvera Elezaj, ta administrojë, ta përdorë apo ta japë me qira, nga ana e subjektit, me prokurën nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol, të datës 13.12.2022. Subjekti sqaroi se motra Pranvera Elezaj, banon në një shtëpi pronë e saj, në rr. “A. F”, pallati nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Për mobilimin e apartamentit ku jeton subjekti, në pronësi të motrës, shpjegoi se ai është mobiluar nga qiradhënësit, pra nga motra e tij, Pranvera Elezaj.

### **Bashkëlidhur shpjegimeve, në funksion të hetimit administrativ, subjekti i vlerësimit paraqiti:**

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të Pranvera Elezaj, ku për periudhën 2019 - 2022, evidentohen pagesa qiraje nga shtetas të tjerë dhe konkretisht: për vitin 2019, shuma 4, 414 euro; për vitin 2020, shuma 5, 585 euro; për vitin 2021, shuma 2, 970 euro; për vitin 2022, shuma 4, 800 euro; dhe për vitin 2023, deri në datë 27.02.2023, shuma 360 euro.

Lidhur me apartamentin e mësipërm, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Pranvera Elezaj ka në pronësi 2 apartamente në rr. “K. P”, konkretisht apartament me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 89 m<sup>2</sup> dhe apartament me nr. pasurie \*\*\* me sipërfaqe 76.5 m<sup>2</sup>.

Subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse duke u shprehur se: *“Motra ime Pranvera Elezaj, zotëron në pronësi dy apartamente me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 89 m<sup>2</sup> dhe nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 76.5 m<sup>2</sup>, të regjistruara nga kadastra me adresë rr. K. P nr.\*\*\* dhe nr.\*\*\*, Tiranë.*

*Që në fazën e ndërtimit, ato janë bashkuar fizikisht në një apartament të vetëm prej 165.5m<sup>2</sup>, por nuk janë kryer veprimet në kadastër për bashkim dhe nxjerrjen e një certifikate. Adresa e dhënë nga Njësia Administrative për këtë apartament, është rr. “H. K” Nd.\*\*, H.\*\*, Nj. Administrative nr. 5, 1022, Tiranë, adresë të cilën e kam vendosur dhe te deklarata e pasurisë dhe interesave private.*

*Për rrjedhojë, kontrata e qiradhënies ndërmjet bashkëshortes time Iris Hodaj dhe motrës time Pranvera Elezaj, është bërë për sipërfaqen reale dhe fizike prej 165.5 m<sup>2</sup> (duke mbledhur sipërfaqet e të dyja apartamenteve sipas certifikatave të pronësisë). Bashkëlidhur, certifikatat e pronësisë së dy apartamenteve, të lidhur fizikisht por jo hipotekisht...”*

### **Bashkëlidhur shpjegimeve, në funksion të hetimit administrativ, subjekti i vlerësimit paraqiti:**

- Certifikatë për regjistrim pronësie me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 89 m<sup>2</sup>, në emër të Pranvera Veli Elezaj

- Certifikatë për regjistrim pronësie me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 76.5 m<sup>2</sup>, në emër të Pranvera Veli Elezaj

### **Konkluzion:**

Trupa e Vlerësimit nga hetimi administrativ kryesisht, duke verifikuar përputhshmërinë e deklaramëve të subjektit me dokumentacionin e administruar konkludoi se:

- *Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e Credins Bank.*
- *Nga verifikimi i llogarisë bankare pranë Credins Bank, konfirmohen pagesat për shlyerjen e qirasë në drejtim të Pranvera Elezaj.*
- *Shuma e detyrimit të paguar për qira banese nga subjekti i vlerësimit, për periudhën shkurt 2019 – shkurt 2023, rezulton të jetë në vlerën 2, 940 euro, konvertuar në total rreth 353, 000 lekë.*
- *Shuma e detyrimit të mbetur rezulton të jetë 10, 440 euro, konvertuar në total 1, 190, 000 lekë.*

### **Deklarimi i shpenzimeve të subjektit të vlerësimit.**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, d, dh, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaroi shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha pagesat periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij ose të personave të lidhur; udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara; arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklaramit apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, subjekti deklaroi:

1. Shpenzime për qira apartamenti, për vitin 2022, në rr. “H. K”. Shuma 4, 800 euro.
2. Faturat e ujit nga UKT, për vitin 2022. Shuma 31, 151 lekë.
3. Faturat e energjisë elektrike, për vitin 2022. Shuma 77, 135 lekë.
4. Shpenzime për telefon celular nga kompania telefonike Vodafone, për të gjithë familjen, katër numra telefonik me ofertë 500 lekë/muaj, si punonjës policie dhe familjarët e tij. Shuma 24, 000 lekë.
5. Shpenzime për internet në banesë, për vitin 2022, kontratë me kompaninë Digicom, 1, 900 lekë/muaj. Shuma 22, 800 lekë.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë qiraje, datë 28.01.2019, për apartament në rr. “P. K”, Tiranë, Qiradhënës: Ervin Hodaj. Qiramarrës: D. Sh dhe T. S. Qiraja: 300 euro/muaj, do të paguhet në llogarinë e shtetas Pranvera Elezaj. Afati: 01.02.2019 - 31.01.2020. Tatimi për qiranë mujore do të paguhet nga qiradhënësi.

- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 23.12.2019 lëshuar nga Ervin Hodaj, Iris Hodaj dhe Pranvera Elezaj,
- Kontratë qiraje, datë 02.02.2022, për apartament në rr. “P. K”, Tiranë. Qiradhënës: Ervin Hodaj. Qiramarrës: O. B dhe E. B. Qiraja: 400 euro/muaj do të derdhet në llogarinë e Pranvera Elezaj. Afati: 05.02.2022 - 04.02.2023. Me mbarimin e afatit palët mund të rinovojnë kontratën.
- Kontratë qiraje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, për apartament në rr. “H. K”, Tiranë. Qiradhënës: Pranvera Elezaj. Qiramarrës: Iris Hodaj. Qiraja: 180 euro/muaj. Afati: 13.12.2022 - 13.12.2027.
- Të dhëna nga sistemi UKT, për kontratë nr. \*\*\*, për apartament në emër të abonentit Pranvera Elezaj, në rr. “R. Zh”, për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, ku janë paguar gjithsej 31, 151 lekë.
- Të dhëna nga sistemi OSHEE, kodi i klientit TRI\*\*\*230, për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, ku janë paguar gjithsej 77, 140 lekë (pa emër).

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se:

**FSHU**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Ervin Hodaj, rezulton e lidhur një kontratë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike me nr. TR1 \*\*\*088, në instancën Tiranë, me adresë: “A. R. Sh, 2, \*\*\*”, Selitë, Tiranë.

**UKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Ervin Hodaj, rezulton kontrata nr. \*\*\*, për objektin me adresë rr. “I. T”, me status “Aktiv”.

**Bashkëlidhur:** Vërtetim nga dokumenti hipotekor, nr. \*\*\*, datë 24.08.2007, për apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, rr. “I. T”, Tiranë, regjistruar në emër të Ervin Hodaj.

**14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. \*\*\* prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Vodafone Albania**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.07.2023, konfirmon 4 numra telefoni në emër të Iris Hodaj dhe 1 numër telefoni, regjistruar në emër të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier. Për të 5-të numrat e telefonit, për vitin 2022 janë shpenzuar në total. 27, 216 lekë.

**Digicom**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Albania Satellite Communications**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 07.06.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Abissnet**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se adresa e apartamentit në pronësinë e motrës Pranvera Elezaj është rr. “H. K”, Nd. \*\*\*, Hyrja \*\*\*, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë dhe rr. “R. Zh” është afër rr. “H. K” dhe UKT, kontratën e sipërpërmendur të ujit e ka vendosur në

këtë adresë. Pra të dyja këto adresa, i referohen të njëjtit apartament. Për apartamentin në pronësi të subjektit në rr. “P. K” (ose “I. T”), faturat e ujit janë paguar nga qiramarrësit e apartamentit.

Subjekti gjithashtu sqaron se kontrata e energjisë elektrike, me nr. TR1\*\*\*230, është kontrata e banesës së shtetasës Pranvera Elezaj, por figuron akoma në emër të firmës ndërtuese “Pajtoni” sh.p.k, pasi nuk janë bërë ende ndryshimet në FSHU.

Kontrata me nr. TR1\*\*\*088, është kontrata e banesës së subjektit në rr. “P. K”, ku edhe këtu pagesat e faturave të energjisë janë bërë nga qiramarrësit e apartamentit. Aktualisht paguhet nga shtetasja Pranvera Elezaj e cila e ka marrë në përdorim. Mos rakordimi i adresës së banesës së subjektit, me adresën e kontratës së FSHU, është për shkak të ndryshimit të shpeshtë të adresave nga ana e Njësive Bashkiake, dhe mos rakordimi i tyre me institucione te tjera, siç është në këtë rast dhe FSHU.

Për shpenzimet e internetit, deklaron se kontrata me Digicom është e lidhur ndërmjet pronarit të apartamentit, znj. Pranvera Elezaj dhe Digicom. Por meqë subjekti është qiramarrës dhe e shfrytëzon këtë shërbim, shpenzimet mujore paguhet prej tij.

Për shpenzimet e qirasë, deklaron se për periudhën 01.02.2019 - 31.10.2020, pagesa e qirasë është shlyer 100 euro në muaj nga ana subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe 300 euro në muaj nga qiraja e apartamentit të dhënë në rr. “P. K”; për periudhën 01.12.2020 - 31.01.2022, pagesa e qirasë është shlyer 70 euro nga ana e subjektit dhe bashkëshortes dhe 330 euro nga qiraja e apartamentit të dhënë në rr. “P. K”; për periudhën 05.02.2022 - 04.02.2023, pagesa e qirasë është shlyer vetëm nga qiraja e apartamentit në rr. “P. K”, të derdhura të gjitha në llogarinë e Pranvera Elezaj në Credins Bank. **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Kontratë nr. \*\*\*, lidhur mes Ervin Hodaj dhe UKT Tiranë, për apartament me adresë në rr. “I. T”, Shk. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë.
- Kontratë lidhur mes Ervin Hodaj dhe OSHEE, me nr. TR1\*\*\*088, për apartament me adresë në rr. “R. Sh”, Pall. \*\*\*, Shk. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Tiranë.
- Kontratë e lidhur me Pranvera Elezaj dhe Digicom, datë 31.08.2022, me pagesë mujore 1, 890 lekë. Amendament kontrate datë 11.12.2018.
- Kopje ID për shtetasen Pranvera Elezaj.

### **Konkluzion:**

- *Informacionet e dërguara nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklarin e subjektit të vlerësimit.*
- *Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefon dhe internet, për subjektin dhe personat e lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, janë në total rreth 158, 000 lekë.*
- *Lidhur me shpenzimet e qirasë së apartamentit ku jeton, për gjithë periudhën e qiramarrjes 2019 - 2023, rezulton se subjekti i ka paguar motrës së tij shumën totale rreth 2, 940 euro ose 353, 000 lekë, pasi pjesa tjetër e qirasë së saj është mbuluar nga qiraja e apartamentit në pronësi të tij, paguar drejtpërdrejtë nga qiramarrësit në llogarinë e motrës, Pranvera Elezaj.*

🚩 Në mbështetje të nenit 33, pika 1/d, subjekti deklaron:

- 1) Udhëtim në Prishtinë, nga pika kufitare Morinë, datë 05 – 07 dhjetor 2022. Rreth 200 euro.
- 2) Udhëtim në Athinë, Greqi, nga pika kufitare Rinas, datë 16 - 17 dhjetor 2021. Rreth 300 euro.



- 3) Udhëtim familjarisht në Korfuz, Greqi, nga pika kufitare Porti Sarandë, datë 24 - 27 korrik 2021. Rreth 600 euro.
- 4) Udhëtim në Prishtinë, nga pika kufitare Morinë, datë 02 - 03 shkurt 2021. Rreth 150 euro.
- 5) Udhëtim i bashkëshortes Iris Hodaj në Prishtinë, Kosovë, nga pika kufitare Morinë, në datë 28.11.2021. Rreth 100 euro.
- 6) Udhëtim i bashkëshortes në Firence, Itali, nga pika kufitare aeroporti Rinas, datë 07 - 11 qershor 2022. E ftuar së bashku me motrën e saj B. K, nga motra tjetër shtetasja E. D, banuese në Toronto, Kanada, e cila ka mbuluar të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit. Shuma 995 euro. **Bashkëlidhur deklaratës:**
  - Faturë për rezervim udhëtimit datë 06.05.2022, nga E. D, në shumën 995 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket udhëtimeve të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezultoi se: **Me procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se udhëtimet e lartpërmendura, kanë qenë udhëtime private dhe nuk disponon ndonjë dokument justifikues, pasi nuk i ka ruajtur. Burimet financiare kanë qenë të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Lidhur me udhëtimin e bashkëshortes në Itali me motrën e saj, subjekti sqaroi se motra e bashkëshortes, që nga viti 2000 jeton në Toronto, Kanada. Në profesion është kirurge, onkologe e përgjithshme, në New\*\*\* On\*\*\*, ku për periudhën 2022 - 2023 ka qenë shefe e kirurgjisë. Çdo vit organizohen konferenca të ndryshme mjekësore në të gjithë botën, ku ajo merr pjesë, dhe një nga këto konferenca është zhvilluar në qershor 2022, në Firence, Itali. Meqenëse motra e tyre e dytë, B. K, kishte ditëlindjen në këtë periudhë (08.06.2022), ka ftuar bashkëshorten dhe motrën tjetër B. K për të shkuar në Firence në datat 07 - 11 qershor 2022, së bashku dhe me dy vajzat e saj binjake. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit janë mbuluar nga motra E. D.

### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Raportet e sistemit TIMS të tij, bashkëshortes dhe fëmijëve.
- E-mail datë 24.02.2023, dërguar nga shtetasja E. D, Iris Deliallisit, ku ka bashkëlidhur mandat pagesë qëndrimi në hotel, datë 10.06.2022, në shumën 90 euro, dhe mandat pagesë datë 10.06.2022, në shumën 962 euro.

### **Konkluzion:**

- ✓ *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje – daljeve nga Republika e Shqipërisë, gjatë periudhës 2020 – 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.*
- ✓ *Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me udhëtimet jashtë shtetit, qëllimin e tyre dhe burimin financiar të mbulimit të shpenzimeve.*
- ✓ *Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale të subjektit dhe personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë në total rreth 1, 350 euro, konvertuar rreth 155, 000 lekë dhe janë pasqyruar në analizën financiare të kryer nga Trupa e Vlerësimit sipas periudhave përkatëse. (Aneksi I)*

- ✓ **Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim shpenzimin e vlerës prej 155, 000 lekë për udhëtime.**

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/dh, subjekti deklaron:

- Shpenzime për arsimimin për Ervin Hodaj, “Bachelor” në Drejtësi, shkolla e lartë universitare “\*\*\* University”, periudha 04/2011 - 09/2013. Shuma 110, 000 lekë.
- Shpenzime për arsimimin për Ervin Hodaj, master profesional “E drejtë penale”, Universiteti \*\*\*, periudha 10/2017 - 03/2019. Shuma 90, 000 lekë.
- Arsimitimi i dy fëmijëve në shkollën 8-vjeçare jo publike “\*\*\*\*”, Enea Hodaj për vitet 2014 - 2023 dhe Damian Hodaj 2016 - 2023, sipas vërtetimeve të kësaj shkolle, konkretisht:
  - Viti 2014 – 2015, Enea Hodaj, paguar 99, 000 lekë;
  - Viti 2015 – 2016, Enea Hodaj, paguar 154, 000 lekë;
  - Viti 2016 – 2017, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 265, 149 lekë,
  - Viti 2017 – 2018, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 155, 876 lekë,
  - Viti 2018 – 2019, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 241, 250 lekë,
  - Viti 2019 – 2020, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 347, 500 lekë,
  - Viti 2020 – 2021, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 319, 000 lekë,
  - Viti 2021 – 2022, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 262, 800 lekë,
  - Viti 2022 – 2023, Enea dhe Damian Hodaj, paguar 254, 600 lekë.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018, lëshuar nga shkolla “\*\*\*\*”, e cila vërteton se për nxënësit Enea dhe Damian Hodaj, janë kryer pagesat për vitin shkollor 2014 – 2015 - 99, 000 lekë; 2015 - 2016 - 154, 000 lekë; 2016 – 2017 - 265, 149 lekë dhe 2017 – 2018 - 155, 876 lekë.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.02.2023, lëshuar nga shkolla “\*\*\*\*”, e cila vërteton se për nxënësit Enea dhe Damian Hodaj, janë kryer pagesat për vitin shkollor 2018-2019 - 241.250 lekë; 2019 - 2020 – 347, 500 lekë; 2020 – 2021 – 319, 000 lekë; 2021 – 2022 – 262, 800 lekë dhe 2022 – 2023 – 254, 600 lekë.

#### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket shpenzimeve për arsimim të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se:

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaron se shpenzimet për arsimimin e tij “Bachelor” në Drejtësi, në Universitetin “\*\*\*\*”, në periudhën prill 2011 - shtator 2013, në shumën prej 110, 000 lekë, i ka mbuluar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Nga komunikimi që ka pasur me këtë universitet, nuk kanë arritur t'i venë në dispozicion dokumentacion mbi pagesën. Edhe shpenzimet për studimin në Universitetin \*\*\*, në Vlorë, në shumën 90, 000 lekë, i ka

mbuluar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Për arsimimin e dy fëmijëve në shkollën jopublike \*\*\*, burim financiar kanë qenë të ardhurat nga pagat, gjendja cash dhe tërheqjet bankare nga llogaria e bashkëshortes në Raiffeisen Bank.

### **Bashkelidhur paraqiti:**

– Faturë nga Universiteti \*\*\*, për studentin Ervin Hodaj, në shumën 90, 000 lekë.

Gjithashtu subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me shpenzimet për arsimimin në Universitetin \*\*\*, për periudhën prill 2011 – shtator 2013 ku shprehet se: “...Lidhur me shpenzimet e mia për arsimimin tim në Universitetin \*\*\*, për periudhën prill 2011 - shtator 2013, në vlerën 110, 000 lekë, nuk i kam ruajtur faturat e pagesave. Për rrjedhojë, nuk jam në gjendje të konfirmoj me saktësi sa ka qenë ky shpenzim i shtrirë në vite shkollore apo kalendarike. Por për sa më kujtohet duhet të jetë ndarë në dy vite kalendarike prej 55, 000 lekë secila...”

### **Konkluzion:**

- *Informacionet e dërguara nga institucionet arsimore lidhur me arsimimin fëmijëve të subjektit të vlerësimit, përputhen me deklarin e subjektit.*
- *Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e subjektit të vlerësimit dhe fëmijëve për periudhën 2011 – 2022, janë në total rreth 2, 299, 000 lekë.*
- *Nga analiza financiare (Aneksi 1), rezulton se subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera për arsimim.*

## **DEKLARIMI I BASHKËSHORTES IRIS HODAJ**

### **Deklarimi i pasurisë**

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, Znj. Iris Hodaj, në pasqyrën e deklaramit të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

- 1.** Llogari bankare për kalimin e pagës, nr. \*\*\*. Banka Raiffeisen. Vlera 45 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Iris Deliallisi (Hodaj), në datë 27.02.2023, ka llogari page me gjendje 45 lekë.

Në procesverbalin e datës 27.09.2023, lidhur me pyetjen nëse bashkëshortja e subjektit, zotëron pasuri të regjistruara me mbiemrin e vajzërisë Deliallisi, subjekti shpjegoi se bashkëshortja e tij nuk ka pasuri tjetër, përveç sa deklaruar me mbiemrin e saj të vajzërisë Deliallisi.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë bankare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.*

**2.** Llogari kartë krediti nr. \*\*\*. Vlera 500 euro. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga paga.

**Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Iris Deliallisi, ka llogari për tërheqje Master Card me gjendje 104 euro.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, lidhur me kartën e kreditit të bashkëshortes në monedhën euro, subjekti deklaron se vlera e deklaruar e llogarisë, prej 500 euro, ka qenë vlera limit e kësaj karte. Në momentin e plotësimit të formularit, karta ka qenë pa detyrime ndaj bankës. Më datë 27.02.2023 nëpërmjet Raiffeisen-on është bërë pagesa e kartës në shumën 104 euro.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së kartës së kreditit të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se ***deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Raiffeisen Bank.***

**3.** Llogari kartë krediti nr. \*\*\*. Vlera 50.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Nga paga.

**Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Iris Deliallisi, në datë 27.02.2023, ka llogari për tërheqje Master Card, me gjendje 0 lekë.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, lidhur me kartën e kreditit të bashkëshortes në monedhën lekë, subjekti deklaron se karta e kreditit në vlerën 50, 000 lekë, është krijuar overdraft nga paga e bashkëshortes, por mënyra e pagesës së detyrimeve bëhet nëpërmjet mbajtjes së detyrimit (nëse ka) automatikisht nga paga, nga vetë banka.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së kartës së kreditit të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se ***deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e Raiffeisen Bank.***

**4.** Gjendje cash, 2, 500 euro. Vlera 1, 500 euro. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Kursime familjare.

**Procedura e vlerësimit:**

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaron se gjendja cash në datën dorëzimit të deklaratës, ka qenë në vlerën 1, 500 euro.

***Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe mundësisë për kursimin e vlerës prej 1, 500 euro në datën shkurt 2023, ka kryer analizën financiare përkatëse (Aneksi 1), dhe rezulton se personi i lidhur me subjektin e vlerësimit ka pasur mundësi për kursimin e gjendjes cash.***

- 5.** Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank. Vlera 5, 267 euro. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Shuma 4, 990 euro nga dëshmia e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol. Dieta OSCE 1, 431 euro. Shitja e automjetit tip Audi, në shumën 12.000 euro.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 4\*\*6 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 12.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët e shkallës së parë: F.D, E.D, B.D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), të cilët përfitojnë 1/4 e pasurisë.
- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët: F. D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), pasi trashëgimtarët e tjera, E. D dhe B. K (Deliallisi), kanë hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021.
- Deklaratë noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021, lëshuar nga E. D dhe B. K (Deliallisi), të përfaqësuara me prokurë nga Iris Hodaj, të cilat deklarojnë se në cilësinë e trashëgimtareve të A. D, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. 4\*\*6 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 12.11.2021, heqin dorë nga e gjithë pasuria që vjen trashëgim nga trashëgimlënësi A. D.

#### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket llogarisë në euro të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezulton se:

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Iris Deliallisi, në datë 27.02.2023 ka llogari rrjedhëse me gjendje 5, 267 euro.

Nga verifikimi i llogarisë konstatohen kreditime dhe debitime nga Iris Hodaj konkretisht:

- Më datë 29.02.2016, Iris Hodaj ka derdhur në llogari një shumë prej 20, 000 euro me përshkrimin “*Kësti i parë për shitjen e shtëpisë*”; (Trajtuar më poshtë).
- Më datë 15.04.2016, është kredituar në llogari një shumë prej 12, 000 euro, me përshkrimin “*Iris Hodaj, derdh në llogari shitje automjeti*”; (Trajtuar më poshtë).
- Më datë 28.12.2016, është debituar një shumë prej 20, 000 euro me përshkrimin “*Iris Hodaj tërheq për kalim në një bankë tjetër*”; (Trajtuar më poshtë).
- Më datë 25.10.2017, Iris Hodaj ka kaluar në llogarinë e Pranvera Elezaj, një shumë prej 5, 025 euro me përshkrimin “*Kthim detyrimi*”; (Trajtuar më poshtë).
- Më datë 15.12.2017, është kredituar në llogari një shumë prej 707 euro nga Easo Regional Events Malta (Veprimtari në Asylum Support Office, sipas faturës se rimbursimit të kësaj qendre).
- Më datë 12.02.2020, Iris Hodaj ka tërhequr nga banka një shumë prej 4, 000 euro.
- Më datë 03.12.2020, janë kredituar në llogari 240 euro nga OSCE.
- Më datë 14.12.2020, janë kredituar në llogari 112 euro nga OSCE.
- Më datë 19.10.2021, janë kredituar në llogari 127 euro nga OSCE.
- Më datë 04.11.2021, janë kredituar në llogari 73 euro nga OSCE.
- Më datë 16.12.2021, janë derdhur në llogari 4, 990 euro me përshkrimin “*Të ardhura nga akti i trashëgimisë nr. rep 5\*\*5, kol nr. 2\*\*1*”; (sipas vendimit për lëshimin e dëshmisë së

*trashëgimisë ligjore nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021 dhe deklaratës noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021).*

- Më datë 20.06.2022, janë kredituar në llogari 370 euro nga OSCE.
- Më datë 21.07.2022, janë kredituar në llogari 387 euro nga OSCE.
- Më datë 28.07.2022, janë kredituar në llogari 49 euro nga OSCE.
- Më datë 30.12.2022, Iris Hodaj ka tërhequr nga llogaria shumë prej 1, 000 euro.
- Më datë 15.02.2023, Iris Hodaj ka tërhequr nga llogaria shumë prej 500 euro.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarin e personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezultojn se:

- ***Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, ku evidentohet kalimi në llogari i shumë 4, 990 euro, me burim të ardhura nga trashëgimia, si dhe kreditimi i një shume prej 1, 360 euro nga OSCE.***
- ***Nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të personit të lidhur me subjektin.***
- ***Shitja e automjetit Audi dhe të ardhurat e babait të bashkëshortes së subjektit janë trajtuar më poshtë.***

**6.** Llogari rrjedhëse në Credins Bank. Vlera 7, 432 euro. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Dëshmia e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se Iris Hodaj, në datë 27.02.2023, ka depozitë me gjendje 7, 431 euro. Kjo depozitë ka si burim transferimin e një shume prej 7, 432 euro, në datë 16.12.2021, me përshkrimin “*kalim sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, ½ e pjesës*”.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, lidhur me likuiditetet e përfituara me trashëgimi nga bashkëshortja, deklarojn se me dëshminë e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep., nr. 2\*\*1 kol., datë 24.11.2021, bashkëshortja e tij ka trashëguar nga babai ½ pjesë takuese në llogaritë bankare në Raiffeisen dhe Credins Bank. Llogaria në euro në Credins Bank, në emër të babait të bashkëshortes, të ndierit A. D, është krijuar nga shitja e apartamentit në qytetin e Shijakut, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep, dhe nr. \*\*\* kol, të datës 16.06.2016, në vlerën 13, 840 euro. Këtë apartament, babai i bashkëshortes e ka përfitur me privatizimin e banesave, ndërsa llogarinë në euro në Raiffeisen Bank, babai i bashkëshortes e ka krijuar nga kursimet familjare.

Për burimet financiare të familjes së bashkëshortes ndër vite, subjekti deklaroi se, deri në vitin 2006, familja e bashkëshortes përbëhej nga bashkëshortja Iris Deliallisi (Hodaj), prindërit A. D dhe F. D, motra B. D (Kola) dhe motra tjetër E. D. Prindërit e bashkëshortes kanë qenë gjithmonë në marrëdhënie pune, si mësues në Shijak deri në ditën e daljes në pension të tyre, babai i saj në vitin 1991 dhe nëna në vitin 2003. Bashkëshortja ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë dhe në nëntor të vitit 2001 ka filluar punë si shefe sektori juridik në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil deri në vitin 2006. Motra e bashkëshortes, B. D ka mbaruar Fakultetin e Historisë në vitin 1997. Në këtë vit ka filluar punë pranë Bashkisë Shijak, si lektore në muzeun e qytetit deri në vitin 2001. Më pas, deri në vitin 2002 ka punuar pranë Bashkisë Shijak. Motra tjetër e

bashkëshortes, E. D ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë në vitin 1994. Nga ky vit deri në vitin 2000, ka kryer specializimin në Milano, Itali, për kardiokirurgji, ku trajtohej financiarisht. Nga viti 2000 dhe aktualisht jeton dhe punon në Toronto, Kanada. Prindërit e bashkëshortes janë shtetas kanadez dhe shkojnë çdo vit në Kanada për një periudhë disa mujore, madje F. D ka qenë e punësuar si mirëmbajtëse zyre në spitalin “So\*\*\*e Re\*\*\*al He\*\*\*th C\*\*\*er” në Toronto, Kanada. Aktualisht trajtohet me pension nga shteti kanadez, ashtu si është trajtuar dhe bashkëshorti i saj deri në kohën kur ndërroi jetë. Gjithashtu familja ka marrë të ardhura nga dhënia me qira të dyqanit që kanë në pronësi.

### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 5\*\*5 rep., nr. 2\*\*1 kol., datë 24.11.2021.
- Kontratë shitblerje, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 16.06.2016, për pasurinë e llojit apartament me sip. 62.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Shijak. Shitës: A.D, F.D, B.D dhe E. D (kjo e fundit përfaqësuar me prokurë nga Iris Deliallisi). Blerës: V. Sh dhe I. Sh. Çmimi: 13, 840 euro, likuiduar ne llogarinë e A. D në Credins Bank.
- Mandat bankar në Credins Bank, ku evidentohet në datë 16.06.2016, derdhje e shumës 13, 840 euro, me përshkrimin “*J. Sh, për blerje apartamenti*”.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.09.2023, lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ku vërteton se Iris Deliallisi, për periudhën 21.11.2001 - 08.04.2006, ka përfutuar te ardhura nga paga, në shumën 1, 338, 668 lekë.
- Kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.09.2023 dërguar nga ISSH për Iris Hodaj, ku informon se F. D trajtohet me pension pleqërie, me masë aktuale 29, 683 lekë. Të ardhurat nga pensioni për periudhën 14.01.2003 - 30.09.2023, janë në total në shumën 5, 069, 152 lekë. A. D është trajtuar me pension pleqërie me masë mujore deri kur ka ndërruar jetë, në shumën 21, 328 lekë. Të ardhurat nga pensioni për periudhën 01.09.1991 - 14.10.2021, janë në shumën 4, 083, 143 lekë.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, për pasurinë e llojit njësi, me nr. pasurie \*\*\*, në Shijak, regjistruar në emër të F. D, për <sup>4/6</sup> pjesë.
- Librezë pune për B. D, për periudhën 1997 - 2006.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2011 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2012 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 11, 000 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2013 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 11, 994 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2014 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 001 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2016 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad (e punësuar nga E. D).
- Deklarim të ardhurash për vitin 2018 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad (e punësuar nga E. D).
- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2020 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 2, 301 cad.
- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2020 nga A. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 2, 300 cad.

- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2021 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 1, 871 cad dhe përfituese taksash në shumën 3, 184 cad.

### **Konkluzion:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli sa i përket llogarisë rrjedhëse të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, ku rezultoi se:

- *Nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të personit të lidhur me subjektin.*
- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe konfirmimin e Credins Bank, ku evidentohet kalimi në llogari i shumës 7, 432 euro me burim të ardhura nga trashëgimia.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues për burimin financiar të familjarëve të bashkëshortes.*

**7.** Pasuri e paluajtshme, lloji apartament, sip. 83,5 m<sup>2</sup>, rr. “T. D”, ndërtesa “K\*\*\*a”, shk. \*\*\*. K. P”, Tiranë, <sup>1/4</sup> pjesë takuese. Vlera 0. Zotërimi 0%. Burimi i krijimit: Dëshmia e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol. Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. 5\*\*6 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 20.12.2021, mamasë sime F. D.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 4\*\*6 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 12.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët e shkallës së parë: F. D, E. D, B. D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), të cilët përfitojnë  $\frac{1}{4}$  e pasurisë.
- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët: F. D, dhe Iris Deliallisi (Hodaj), pasi trashëgimtarët e tjera, E. D dhe B. K (Deliallisi), kanë hequr dorë nga trashëgimia në deklaratën noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 10.12.2021, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 83, 5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë, regjistruar në emër të Iris Hodaj për  $\frac{1}{4}$  pjesë. Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë e llojit apartament me sip. 83, 5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë, regjistruar në emër të F. D për  $\frac{3}{4}$  pjesë dhe Iris Hodaj për  $\frac{1}{4}$  pjesë.
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 20.12.2021, ku dhuruesja Iris Hodaj, i dhuron pjesën e saj takuese të  $\frac{1}{2}$  të pasurisë së llojit apartament me sip. 83, 5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, nënës së saj, F. D. Kjo pasuri është përfituar nga vendimi i dëshmisë së trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021.

### **Trajtuar më poshtë.**

**8.** Pasuri e paluajtshme lloji apartament, sip. 57, 8 m<sup>2</sup>, rr. “H. B”, nd. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Vlera 0. Zotërimi 0%. Burimi i krijimit: Dëshmia e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol. Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. 5\*\*6 rep, nr. 2\*\*0 kol, datë 21.12.2021, mamasë sime F. D.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**



- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 4\*\*6 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 12.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët e shkallës së parë: F.D, E.D, B.D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), të cilët përfitojnë ¼ te pasurisë.
- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, 24.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët: F.D, dhe Iris Deliallisi (Hodaj), pasi trashëgimtarët e tjera, E. D dhe B. K (Deliallisi), kanë hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 07.12.2021, për pasurinë e llojit apartament me sip. 57, 8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë, regjistruar në emër të Iris Hodaj për ¼ pjesë. Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë e llojit apartament me sip. 57, 8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Tiranë, regjistruar në emër të F. D për ¾ pjesë dhe Iris Hodaj për ¼ pjesë.
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 21.12.2021, ku dhuruesja Iris Hodaj i dhuron pjesën e saj takuese të ¼ të pasurisë së llojit apartament me sip. 57, 8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, nënës së saj, F. D. Kjo pasuri është përfituar nga vendimi i dëshmisë së trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021.

### **Trajtuar më poshtë.**

- 2.** Pasuri e paluajtshme lloji njësi, sip. 70 m<sup>2</sup>, Shijak, Durrës, 2/6 pjesë takuese. Vlera 0. Zotërimi 0%. Burimi i krijimit: Dëshmia e trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol. Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 14.06.2022, mamasë sime F. D.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 4\*\*6 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 12.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët e shkallës së parë: F. D, E. D, B. D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), të cilat përfitojnë ¼ e pasurisë.
- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021, për të ndjerin A. D, ku janë përcaktuar trashëgimtarët: F. D dhe Iris Deliallisi (Hodaj), pasi trashëgimtarët e tjera, E. D dhe B. K (Deliallisi), kanë hequr dorë nga trashëgimia me deklaratën noteriale nr. 4\*\*7 rep, nr. 1\*\*6 kol, datë 16.11.2021.
- Certifikatë regjistrimi pronësie, datë 18.12.2021, për pasurinë e llojit njësi me sip. 70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Durrës, regjistruar në emër të Iris Hodaj për 2/6 pjesë. Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë e llojit njësi me sip. 70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, Durrës, regjistruar në emër të Iris Hodaj për 2/6 pjesë, A. V për 1/6 pjesë, F. D për 2/6 pjesë dhe A. V për 1/6 pjesë.
- Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 14.06.2022, ku dhuruesja Iris Hodaj i dhuron pjesën e saj takuese të 2/6 të pasurisë së llojit njësi me sip. 70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, nënës së saj, F. D. Kjo pasuri është përfituar nga vendimi i dëshmisë së trashëgimisë nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021.

### **Procedura e vlerësimit për pasuritë e mësipërme:**

**ASHK Tiranë – Drejtoria Vendore Tirana Jug, Drejtoria Vendore Tirana Veri, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, Drejtoria Vendore Kamëz Vorë**, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 26.06.2023, datë 23.06.2023, datë 23.06.2023, datë 07.07.2023, datë 15.06.2023 dhe datë 29.06.2023, nuk konfirmojnë këto pasuri në emër të subjektit Ervin Hodaj dhe personave të lidhur.

Në procesverbalin e datës 27.9.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku lidhur me pasuritë e paluajtshme të përfituara me trashëgimi nga bashkëshortja, deklaroi se:

- Pasuria e llojit “Apartament”, me sip. 83.5 m<sup>2</sup>, në rr. “T. D”, Tiranë, është blerë për prindërit, nga motra e bashkëshortes, E. D. Që nga viti 2009, prindërit e bashkëshortes A.D dhe F. D kanë fituar shtetësinë kanadeze. Prej vitit 2000 e në vazhdim, ata kanë jetuar me periudha të ndara ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë. Bashkëlidhur të ardhurat për disa vite për motrën e bashkëshortes, si kirurge e përgjithshme në N\*\*\*\*\*et On\*\*\*io. Paga e saj mund të gjendet edhe në linkun [https://www.\\*\\*\\*\\*\\*](https://www.*****).
- “Pasuria e llojit” Apartament, me sip. 57. 8 m<sup>2</sup>, rr. “H. B”, Tiranë, është blerë nga prindërit e bashkëshortes. Më datë 20.11.2011, ka ndërruar jetë halla e bashkëshortes, Znj. H. D (Spahiu). Ajo ka lenë një djalë të vetëm, B. S, i datëlindjes 13.07.1973, i cili është i lindur me sindromën Down. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëshortja Iris Hodaj (Deliallisi) është caktuar kujdestare ligjore e djalit të hallës së saj B. S. Me qëllim ofrimin e përkujdesjes gjithëpërfshirëse që i nevojitet B.S, bashkëshortja me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti l\*\*\*6 dhe nr. Vendimi 4\*\*\*8, të datës 24.04.2013, ka shitur apartamentin që B.S ka trashëguar nga nëna e tij, Znj. H. D, në rr. “H. B”, Tiranë, me kontratën nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, të datës 30.07.2013, prindërve të saj A. D dhe F. D, me çmimin 5, 664, 400 lekë. Në kontratë nuk është përcaktuar mënyra e pagesës, dhe jashtë zyrës së noterit është rënë dakord që shuma e blerjes së apartamentit do të shërbejë për pagesën e qëndrimit të B. S në një qendër përkujdesje.

Blerësit do të paguanin çdo muaj detyrimin mujor prej 45, 000 lekë ndaj klinikës, sipas akt marrëveshjes datë 23.11.2011, derisa të plotësohej shuma e çmimit të apartamentit. Kjo vlerë është tejkualuar duke shkuar në 6, 480, 000 lekë dhe përkujdesja ndaj B. S vazhdon edhe aktualisht nga bashkëshortja dhe nga nëna e saj F. D, e cila kalon të ardhurat e qirasë së apartamentit në rr. “H. B” për pagesën e klinikës. Burimet financiare për blerjen e apartamentit, (nëpërmjet pagesave mujore te klinikës) janë krijuar nga të ardhurat e tyre si shtetas kanadez, si të punësuar dhe më pas në pension.

Bashkëlidhur kopje të kontratës së shitblerjes së apartamentit, të ardhurat vjetore për disa vite të F.D dhe A. D, në Kanada, akt-marrëveshja me Klinikën “\*\*\* Center”, si dhe vërtetimi nga kjo klinikë për pagesat e bëra.

- “Pasuria e llojit “Njësi”, sip. 70 m<sup>2</sup>, në Shijak, Durrës, babai i bashkëshortes, A. D ka qenë bashkëpronar i truallit mbi të cilën është kjo pasuri e paluajtshme, ish-farmacit para viteve 90, me sip. 139. 3 m<sup>2</sup>, trashëguar nga babai i tyre Q. D. Për këtë arsye, ka pasur të drejtën e parablerjes së bashku me bashkëpronarët e tjerë (6 pjesëtar). Blerja është bërë, pjesa më e madhe me letra me vlerë dhe pjesa më e vogël me monedhën lekë. Kjo pasuri është ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet bashkëpronarëve. Babai i bashkëshortes dhe dy motrat e tij, janë bërë pronarë të kësaj “Njësie” prej 70 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër i ka takuar dy vëllezërve dhe motrës tjetër të A. D. Me këtë blerje, A.D është bërë pronar i 2/3 pjesë takuese. Bashkëlidhur kopje e dokumentacionit të përfitimit të kësaj prone. Subjekti shton se, bashkëshortja e tij edhe pse është bërë përfituese me akt trashëgimie e pronave të mësipërme ka hequr dorë vullnetarisht duke ja dhuruar nënës së saj, me bindjen se nuk ka asnjë kontribut në krijimin e këtyre pronave.

**Bashkëlidhur paraqiti:**

- Deklarim të ardhurash për vitin 2013 nga E. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 290, 500 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2014 nga E. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 198, 353 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2015 nga E. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 195, 201 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2017 nga E. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 282, 301 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2019 nga E. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 200, 075 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2011 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2012 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 11, 000 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2013 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 11, 994 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2014 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 001 cad.
- Deklarim të ardhurash për vitin 2016 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad (e punësuar nga E. D).
- Deklarim të ardhurash për vitin 2018 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 12, 000 cad (e punësuar nga E. D).
- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2020 nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 2, 301 cad.
- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2020 nga A. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 2, 300 cad.
- Deklarim të ardhurash (pensioni) për vitin 2021, nga F. D, pranë Agjencisë së të Ardhurave në Kanada, në shumën 1, 871 cad dhe përfituese taksash në shumën 3, 184 cad.
- Vendim nr. \*\*\*, datë 16.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, ku është vendosur për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit B. S dhe caktimin si kujdestare shtetasen Iris Hodaj.
- Vërtetim datë 24.07.2023, lëshuar nga qendra “\*\*\* Center”, e cila vërteton se shtetasi B. S është i akomoduar pranë këtij fondacioni prej vitit 2011 e në vazhdim, Iris Hodaj ka paguar që prej fillimit e në vazhdimësi për akomodimin e tij një shumë mujore prej 45, 000 lekë.
- Aktmarrëveshje datë 23.11.2011, lidhur mes “\*\*\* Center” dhe B. S/Iris Hodaj, për akomodimin pranë kësaj qendre, kundrejt shumës 45, 000 lekë në muaj. Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 30.07.2023, për apartament me sip. 57.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në rr. “H. B”, Tiranë. Shitës: B. S, përfaqësuar nga Iris Hodaj. Blerës: F. D dhe A. D. Çmimi: 5, 664, 000 lekë i likuiduar.
- Autorizim datë 13.05.1996, për blerje objekti “Farmacia Shijak”, lëshuar nga dega e AKP Durrës, për A. D.
- Mandat arkëtimi, datë 13.05.1996, nga A. D, i një shume prej 22, 688 lekë, me objekt, “Farmacia Shijak”.
- Mandat arkëtimi, datë 13.05.1996, nga A. D, i një shume prej 345, 000 lekë Bono Privatizimi, me objekt, “Farmacia Shijak”.
- Mandat arkëtimi, datë 13.05.1996, nga A. D, i një shume prej 500 lekë.
- Mandat arkëtimi, datë 13.05. 1996, nga A. D, i një shume prej 90, 000 lekë

- Bono Privatizimi, me objekt, "Farmacia Shijak".
- Kontratë shitje, datë 20.05.1996, për objekt "Farmacia Shijak". Blerës: A. D dhe 9 blerës të tjerë. Shitës: Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës. Çmimi: 453, 760 lekë.
- Akt-dorëzimi nr. 244, prot., datë 29.05.1996, lidhur mes Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës dhe A. D, blerësi i objektit farmaci me sip. 139.3 m<sup>2</sup>.
- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 30.05.1996, për objekt "Farmaci", me sip. 139, 3 m<sup>2</sup>, në Shijak. Blerës: A. D dhe 9 blerës të tjerë, përfaqësuar me prokurë nga A. D. Shitës: Drejtoria e Shëndetit Publik Durrës. Çmimi: 453,760 lekë.
- Është administruar: Kontratë porosie nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.04.2013, për apartament me sip. 83,5 m<sup>2</sup>, në Tiranë. Porositës: A. D. I porositur: shoqëria "K\*\*\*a" sh.p.k. Çmimi: 81, 900 euro, ku 35.000 euro do të paguhen me hartimin e kontratës; 21, 900 euro do të paguhen në qershor të vitit 2014; 22, 000 euro deri në 31 janar 2015 dhe diferenca prej 3, 000 euro në momentin e hipotekimit.

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur, dokumentacionin e paraqitur, si dhe korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Deklarimet përputhen me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK.*
- *Pasuritë e sipërpërmendura janë përfituar nga bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, nëpërmjet vendimeve për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, nr. 5\*\*5 rep, nr. 2\*\*1 kol, datë 24.11.2021, nga i ndjeri A. D (babai i bashkëshortes), e cila ka hequr dorë nga pjesa e saj takuese, ashtu sikurse motrat e saj, në favor të nënës, F. D, nëpërmjet kontratave respektive të dhurimit.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues për burimin financiar të familjarëve të bashkëshortes.*

**10.** Automjet tip Volkswagen Polo, vit prodhimi 1997, me targë DR 7\*\*8 D, shitur në datë 13.11.2008, në shumën 3, 000 euro, shtetases D. T, sipas kontratës. Zotërimi 100%.

### **Bashkëlidhur deklaratës:**

Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.11.2008, për automjet Volkswagen Polo me targa DR 7\*\*8 D. Shitës: Iris Deliallisi. Blerës: D. T. Çmimi: 3, 000 euro i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklarinimet apo mos deklarinimet e subjektit të vlerësimit e konkretisht:

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur me të.

Në procesverbalin e datës 27.09.2023, subjekti deklaroi se automjeti tip Volkswagen Polo, është blerë nga bashkëshortja nga kursimet familjare të saj dhe familjes së saj në vitin 2005, (data e saktë nuk i kujtohet). Dokumentacionin e blerjes së këtij automjeti edhe pas interesimit nuk kanë arritur ta sigurojnë.

#### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.11.2008, për automjet Volkswagen Polo, me targa DR 7\*\*8 D. Shitës: Iris Deliallisi. Blerës: D. T. Çmimi: 3, 000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 19.09.2023, lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, ku vërtetoi se Iris Deliallisi, për periudhën 21.11.2001 - 08.04.2006, ka përfituar të ardhura nga paga në shumën 1, 338, 668 lekë.

#### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur, dokumentacionin e paraqitur, si dhe korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- *Dokumentacioni i blerjes së këtij automjeti, nuk është arritur të administrohet as nga subjekti dhe as nga DPSHTRR.*
- *Pasuria e trajtuar më sipër është krijuar në vitin 2005, dhe ndodhur në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, Trupa e Vlerësimit nuk i është nënshtruar procedurave hetimore me qëllim konstatimin e faktit nëse personi i lidhur me subjektin e vlerësimit e justifikon apo jo ligjshmërinë e burimit të krijimit për këtë pasuri.*

**11.** Automjet tip Peugeot, me targë TR 8\*\*2 R, blerë në datë 05.01.2009, nga shtetasi Q. Gj me shumën 3, 200 euro, shitur në datë 01.10.2014, shtetasit R. Sh, në shumën 2, 000 euro. Zotërimi 100%.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 01.10.2014, për automjet Peugeot, me targa TR 8\*\*2 R. Shitës: Iris Hodaj. Blerës: R. Sh. Çmimi: 2, 000 euro i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

#### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklarinimet apo mos deklarinimet e subjektit të vlerësimit e konkretisht:

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur me të.

**DPSHTRR**, me postën elektronike të datës 19.06.2023, ka bashkëlidhur dosjen e automjetit me targa AA \*\*\* KM (TR 8\*\*2 R):

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 05.01.2009, për automjet Peugeot, me targa gjermane SU M\*\*\*13. Blerës: Iris Hodaj. Shitës: Q. Gj. Çmimi: 3, 200 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 01.10.2014, për automjet Peugeot, me targa TR 8\*\*2 R. Shitës: Iris Hodaj. Blerës: R. Sh. Cmimi: 2, 000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Në **procesverbalin e datës 27.09.2023**, lidhur me automjetin me targa TR 8\*\*2 R, vlerën dhe burimin e tij, subjekti ka sqaruar se blerja është bërë me të ardhurat nga shitja e automjetit tip Volkswagen Polo.

#### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 05.01.2009, për automjet Peugeot, me targa gjermane SU M\*\*\*13. Blerës: Iris Hodaj. Shitës: Q. Gj. Çmimi: 3.200 euro i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 3, 200 Euro për blerjen e automjetit tip Peugeot në vitin 2009, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

#### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga DPSHTRR dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit dhe personi i lidhur, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit në vitin 2009.*

**12.** Automjet tip Audi A1, me targë AA \*\*\* JD, blerë në ankandin e zhvilluar nga zyra përbarimore Gjirokastër, me targa fillestare italiane EJ\*\*\*TV, e amortizuar dhe e dëmtuar, e konfiskuar me Vendim nr. \*\*\*, datë 04.02.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë. Shitur në datë 18.03.2016, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 12, 000 euro. Zotërimi 100%.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.03.2016, për automjet Audi A1, me targa AA \*\*\* JD. Shitës: Iris Hodaj. Blerës: shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Çmimi: 12, 000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se në datë 15.04.2016, në llogarinë e Iris Hodaj është derdhur një shumë prej 12, 000 euro, me përshkrimin "*Iris Hodaj, derdh në llogari shitje automjeti*".

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, nuk konfirmon automjet të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur me të.

**DPSHTRR**, me postën elektronike të datës 20.06.2023, informon se dokumentacioni i përfitimit dhe transferimit të pronësisë së këtij mjeti nga Iris Hodaj, nuk gjendet. **Bashkëlidhur**

#### **DPSHTRR ka dërguar:**

- Deklaratë doganore për zhdoganim mjeti Audi, datë 19.04.2014. Vlera e faturuar e mjedit 100, 000 lekë. Shuma e detyrimit të paguar: 25, 609 lekë.
- Kontratë shitje, datë 02.12.2019, për automjet tip Audi, me targa AA \*\*\* JD. Shitës: shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. Blerës: shoqëria “\*\*\* Group” sh.p.k. Çmimi: 5, 800 euro.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se automjeti me targa AA \*\*\* JD, është blerë në ankandin e zhvilluar nga Zyra Përmbartimore Gjyrokastër, në vlerën 168, 000 lekë, i amortizuar dhe dëmtuar. Automjetit i'u kryen shërbime dhe riparime, për të cilat nuk disponon fatura për shkak të kohës së kaluar. Për këtë automjet janë paguar detyrimet tatimore lidhur me diferencën e përfituar nga çmimi i blerjes me atë të shitjes. **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Urdhër pagesë e kryer nga Iris Hodaj, për tatim të mbajtur në burim, datë 13.09.2023, për pagesën e shumën 138, 300 lekë, me përshkrimin "*tatim për kalimin e të drejtës së pronësisë në shitje*". Mandat pagesë në Raiffeisen Bank.

Në kuadër të hetimit administrativ lidhur me këtë automjet, Trupa e Vlerësimit ka dërguar shkresë Zyrës Përmbartimore Gjyrokastër, me nr. \*\*\*, prot., datë 30.10.2023, me qëllim vënien në dispozicion të praktikës dokumentare lidhur me procedurat e ankandit të zhvilluar nga ana e tyre.

Zyra Përmbartimore Gjyrokastër, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 02.11.2023, protokolluar me tonën nr. \*\*\*, prot., datë 09.11.2023 ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm konkretisht:

- Shpallje nr. \*\*\*, datë 18.12.2013, për shitjen në ankand të sendit të luajtshëm autoveturë, ndodhur në lagjen 18 Shtatori, Gjyrokastër, ku pasqyrohet:

Sendi i luajtshëm ka të dhënat si më poshtë:

Autoveturë Audi A1, me ngjyrë të zezë, me targë EJ \*\*\* TV. Çmimi fillestar me të cilin do të çelet ankandi, është 134, 400 lekë, në bazë të nenit 552 dhe nenit 555 të Kodit të Procedurës Civile. Ankandi fillon në datën 18.12.2013, me fillimin e orarit zyrtar dhe mbaron në datën 23.12.2013 me mbarimin e orarit zyrtar.

- Procesverbal i datës 23.12.2013, mbi zhvillimin e ankandit ku sipas raportit të ekspertit për pasurinë e luajtshme, ky send është vlerësuar në shumën 168, 000 Lekë, ku pasqyrohet:

Në bazë të ofertës së dhënë, bazuar në nenin 556 të Kodit të Procedurës Civile, shpallet fitues ofertuesi i vetëm Znj. Iris Hodaj me nr. Id 02\*\*\*06.

I bëhet e qartë fituesit të ankandit, bazuar në nenin 556 të Kodit të Procedurës Civile, që të paguajë shumën prej 135, 000 Lekë.

- Vendim nr. \*\*\*, datë 18.12.2013, për kalimin e sendit të luajtshëm në favor të blerësit, konkretisht automjetin Audi A1, me ngjyrë të zezë dhe me targë EJ \*\*\* TV, me nr. shasie WA\*\*\*\*\*893, në favor të Znj. Iris Hodaj me nr. Id 02\*\*\*06.

Gjithashtu subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse lidhur me automjetin tip Audi A1, duke u shprehur se: “...Automjeti tip Audi A1, me targa italiane EJ \*\*\* TV, është konfiskuar me Vendim nr. \*\*\*, datë 04.02.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë.

*Kjo makinë është blerë nga bashkëshortja ime Iris Hodaj më datë 23.12.2013, në ankandin e zhvilluar nga Zyra Përmbartimore Gjyrokastër.*

*Shuma e daljes në ankand sipas vlerësimit të sendit ka qenë 168, 000 lekë dhe është blerë për shumën 134, 400 lekë...”*

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për mbulimin e shpenzimeve në vlerën prej 134, 400 lekësh, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi (Aneksi 1).

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarin e subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- *Subjekti i vlerësimit dha shpjegime për blerjen dhe shitjen e automjetit tip Audi, si dhe paraqiti dokumentacion për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti, në shumën 12, 000 euro.*
- *Deklarimi përputhet me shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit si dhe dokumentacionin e paraqitur në funksion të hetimit administrativ nga institucionet përkatëse.*
- *Subjekti i vlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të njaftueshme me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit në vitin 2013.*

### **Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit**

- ❖ Të ardhura nga paga, në funksionin koordinator, në Drejtorinë e Antitrafikut dhe Migracionit dhe si përgjegjëse e Sektorit të Migracionit, në Drejtorinë e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit, në Ministrinë e Brendshme, nga data 01.04.2018 - 01.03.2023, sipas të dhënave të dërguara nga Raiffeisen Bank. Shuma 4, 511, 096 lekë.
- ❖ Të ardhurat në funksionin e koordinatorit, në Drejtorinë e Antitrafikut, në Ministrinë e Brendshme, në periudhën janar 2015 - prill 2018, sipas të dhënave të marra nga Raiffeisen Bank, datë 10.04.2018. Shuma 2, 981, 617 lekë.
- ❖ Të ardhurat në funksionin e specialistit, në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në periudhën prill 2006 - dhjetor 2014, sipas të dhënave të marra nga banka Raiffeisen Bank, datë 10.04.2018. Shuma 4, 483, 754 lekë.
- ❖ Të ardhura nga veprimtari në Asylum Support Office, për vitin 2018, sipas faturës së rimbursimit të kësaj qendre. Shuma 713 euro.
- ❖ Të ardhura nga organizata ndërkombëtare OSCE Presence in Albania: Viti 2020, 352 euro; viti 2021, 271 euro; viti 2022, 807 euro. Dieta për kryerjen e disa takimeve nëpër qarqe me cilësinë e Koordinatorit Antitrafik, përfaqësuese e Autoritetit Përgjegjës, në Ministrinë e Brendshme, për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ri integrimin e viktimave të mundshme të trafikimit.
- ❖ Të ardhura nga qiraja e apartamentit në pronësinë e bashkëshortit në adresën: Rr. “P. K”, nd. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, hyrja \*\*\*, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, për periudhat:
- 01.02.2019 - 31.01.2020, kontratë qiraje lidhur më 28.01.2019, me agjencinë InfoExpress, mes bashkëshortit dhe shtetasve D. Sh dhe T. S, sipas termave të përcaktuar në kontratë. Kontrata



ka vazhduar edhe pas përfundimit deri më datë 31.10.2020, për shkak të pandemisë Covid-19, veprimet kanë vazhduar pa lidhje kontrate. Shuma 6, 300 euro.

- 01.12.2020 - 30.11.2021, kontratë qiraje lidhur mes meje dhe shtetasve M. Ç, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratë, me një çmim prej 330 euro në muaj. Kjo kontratë ka vazhduar deri më datë 31.01.2022. Shuma 4, 620 euro.
- 05.02.2022 - 13.12.2022, kontratë qiraje lidhur mes meje dhe shtetasve O. B dhe E. B, ndërmjetësuar nga agjencia imobiliare Best Home, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratë. Shuma 4, 800 euro.

Tatim i mbajtur në burim për dhënien me qira të apartamentit sipas kontratave më lartë. Palës që i detyrohem: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- Viti 2019 - 2020 - 64, 800 lekë.
- Viti 2020 - 2022 - 149, 969 lekë,
- Periudha shkurt 2022 - dhjetor 2022 - 94, 769 lekë.

Sipas urdhër pagesave të lëshuara për këtë qëllim nga organi kompetent tatimor.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank. për veprimet në llogarinë e Iris Hodaj për periudhën 31.03.2005 - 31.03.2023.
- Kërkesë rimbursimi për udhëtim në Maltë, në periudhën 12.11.2017 - 15.11.2017, në shumën 713 euro.
- Email informues, lidhur me pagesat e rimbursuara të bëra nga IOM për Iris Hodaj, në vitin 2016 - 19, 024 lekë dhe në vitin 2018 - 881 usd.
- Vërtetim të ardhurash datë 20.02.2023, lëshuar nga OSCE, ku vërtetohet se Iris Hodaj për vitet 2020 - 2022, ka përfituar dieta në shumën 1, 431 euro.

#### **Procedura e vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, nga ku rezulton se:

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD me nxjerrjet e llogarive në emër të Iris Hodaj, ku evidentohet se për periudhën 31.03.2005 - 02.02.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, dieta, shpërblime etj.. në shumën 12, 672, 823 lekë. Gjithashtu ka përfituar 707 euro nga Asylum Support Office dhe 1, 360 euro nga OSCE.

**ISSH**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Iris Hodaj disponon të dhëna në sistemin informatik, për periudhën janar 2012 - shkurt 2023, ka të dhëna punësimi, ku ka përfituar të ardhura pranë Aparatit të Ministrisë së Brendshme.

#### **Konkluzion:**

- *Nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me llogarinë bankare të deklaruar nga Znj. Iris Hodaj,*

- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar,*
- *Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat, dietat, shpërblimet, eti. për periudhën 2005 – 02.02.2023, janë në shumën 12, 673, 000 lekë dhe 2, 068 euro, konvertuar rreth 12, 912, 000 lekë.*
- *Të ardhurat e deklaruara nga qiraja, nga ana e bashkëshortes, janë trajtuar më lart në deklarimin e subjektit të vlerësimit.*

## **Deklarimi i detyrimeve financiare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit**

1. Kontratë 5-vjeçare për marrje me qira apartament nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.12.2022, në shumën totale 10, 800 euro, kësti mujor 180 euro plus lënia me akt noterial, në administrim, përdorim me qira, të apartamentit në pronësi të bashkëshortit, në rr. “P. K”, motrës së tij Pranvera Elezaj. Është paguar shuma prej 360 euro, si detyrim për muajt janar dhe shkurt 2023. Shuma e detyrimit financiar: 10, 440 euro. **Trajtuar më lartë.**

### **Shkresat e institucioneve:**

**BKT**, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Fibank, ABI Bank, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandesLease, Raiffeisen Invest, Unioni Financiar Tiranë, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, IUTE Credit, Kredo.al, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, ç’ka konfirmohet me deklarimin.

**ASHK** në Zyrat/Drejtoritë Vendore: Përmet, Tepelenë, Mirditë, Peqin, Pukë, Bulqizë, Tropojë, Durrës, Kukës, Skrapar, Has, Kolonjë, Elbasan, Lezhë, Mallakastër, Lushnjë, Malësi e Madhe, Gramsh, Kavajë, Kuçovë, Pogradec, Berat, Gjirokastër, Korçë, Vlorë, Devoll, Sarandë, Dibër, Kurbin, Mat, Fier, Krujë, Librazhd, Shkodër, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023 konfirmon se:

- Më datë 29.02.2016, në llogarinë e Iris Hodaj, është derdhur një shumë prej 20, 000 euro, me nënshkrimin “*kësti i parë për shitjen e shtëpisë*”. Shuma 20, 000 euro është tërhequr në datë 28.12.2016, me përshkrimin “*për kalim në një bankë tjetër*”.
- Më datë 25.10.2017, Iris Hodaj ka transferuar në llogarinë e Pranvera Elezaj, një shumë prej 5, 025 euro, me përshkrimin “*kthim detyrimi*”.
- Më datë 12.02.2020, Iris Hodaj ka tërhequr nga llogaria një shumë prej 4, 000 euro.
- Më datë 15.06.2010 në llogarinë e Damian Hodaj është transferuar një shumë prej 5, 000 lekë.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.05.2023, konfirmon se në emër të Ervin Hodaj, në datë 06.08.2015, është disbursuar një kredi në shumën 2, 772, 000 lekë. Kjo kredi (së bashku me një shumë prej 20, 000 lekë nga llogaria), është konvertuar nga 2, 792, 000 lekë, në 20, 000 euro dhe më datë 11.08.2015, shuma 20, 000 euro është transferuar në llogarinë e shoqërisë “Pajtoni” sh.p.k., me përshkrimin, “*likuidim kontratë paraprake për blerje apartamenti*”. Kredia është mbyllur në datë 30.12.2016, kur Ervin Hodaj ka arkëtuar në llogari një shumë prej 2, 661, 000 lekë, me përshkrimin “*tërhequr nga Raiffeisen Bank*”.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, për sa konfirmuar nga Raiffeisen dhe Credins Bank, subjekti deklaroi se më datë 23.09.2015, nga ana e bashkëshortes është lidhur një kontratë porosie, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, për blerjen e një apartamenti me sip. 99.5 m<sup>2</sup> dhe një njësie parkimi. Kjo

kontratë, duke parë pamundësinë për shlyerjen e kësteve të pagesave, më pas është anuluar me Aktin e Revokimit nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., të datës 18.02.2016. Me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., të datës 25.02.2016, ndërmjet bashkëshortes së subjektit, shoqërisë “Pa\*\*\*ni” sh.p.k dhe motrës së tij, Pranvera Elezaj, është rënë dakord që shoqëria “Pa\*\*\*ni” sh.p.k, për apartamentin dhe njësinë e parkimit, ta lidhë kontratën me motrën Pranvera.

Apartamenti dhe njësia e parkimit, është deklaruar nga ana e subjektit në deklaratat ndër vite, kur ka kryer pagesën e këstit dhe kur ka revokuar kontratën e porosisë. Subjekti shton se pasuritë në fjalë nuk janë zotëruar asnjëherë prej tij, pasi deri në kohën kur është revokuar kontrata e porosisë, pallati sapo kishte nisur të ndërtohej. PAGESA e këstit të parë prej 20, 000 euro, bërë prej subjektit dhe bashkëshortes, u njoh si likuidim i pjesshëm i znj. Pranvera Elezaj për kontratën e re që ajo do të lidhte me shoqërinë ndërtuese. Motra, shumën 20, 000 euro, ia ka dhënë bashkëshortes cash, jashtë zyrës noteriale, e cila e ka derdhur më datë 29.02.2016, në llogarinë në Raiffeisen Bank dhe më pas, në datë 28.12.2016, është tërhequr nga bashkëshortja për t'u kaluar në Credins Bank, për të paguar dhe mbyllur kredinë e marrë më parë pranë kësaj banke, me qëllim pagesën e këstit të parë prej 20, 000 euro, të porositjes së apartamentit.

Përsa i përket konfirmimit të transaksionit të shumës 5, 025 euro, nga llogaria e bashkëshortes në llogarinë e motrës së tij, subjekti shpjegoi se, së bashku me dy motrat e tij I. M dhe Pranvera Elezaj, duke qenë se kanë lindur dhe kanë kaluar fëmijërinë në fshatin Rexhin, Nivicë, Tepelenë, kanë rënë dakord të rindërtonin dhe të rinovonin banesën e prindërve në fshat, duke i dhënë babait të tyre, V. H, një shumë që do të përdorej prej tij për rindërtimin e shtëpisë. Pjesa takuese që i takonte subjektit për të dhënë ishte 5, 000 euro, të cilën nuk e kishte për momentin gjendje, dhe kjo shumë u shtua cash nga motra e tij Pranvera Elezaj, diku në mesin e vitit 2017 dhe i është rikthyer asaj në datë 25.10.2017, nëpërmjet bankës.

### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Kontratë porosie, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 23.09.2015, për apartament me sip. 99, 5 m<sup>2</sup>, Tiranë. Porositës: Iris Hodaj. Sipërmarrës: shoqëria “Pa\*\*\*ni” sh.p.k. Çmimi: 59, 700 euro. Kësti i parë prej 20, 000 euro i likuiduar. Diferenca prej 39, 700 euro, do të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit.
- Revokim kontrate, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.02.2016, i kontratës së porosisë nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 23.09.2015, për apartamentin dhe njësinë e parkimit, lidhur mes shoqërisë “Pa\*\*\*ni” sh.p.k., dhe Iris Hodaj.
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 25.02.2016, lëshuar nga shoqëria “Pa\*\*\*ni” sh.p.k., Iris Hodaj dhe Pranvera Elezaj, të cilët bien dakord që Iris Hodaj të heqë dorë nga kontrata e porosisë e datës 23.09.2015 dhe likuidimi i këstit të parë prej 20, 000 euro që i është likuiduar shoqërisë, të njihet si likuidim i pjesshëm i çmimit të apartamentit dhe njësisë së parkimit, për lidhjen e kontratës së re midis shoqërisë “Pa\*\*\*ni” sh.p.k., dhe Pranvera Elezaj.
- Plan kredie datë 30.12.2016 në Credins Bank, për kredi në shumën 2, 800,000 lekë, lëvruar në emër të Ervin Hodaj.
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.01.2017, lëshuar nga Credins Bank, e cila shpreh dakordësinë, që pasuria në pronësi të Ervin Hodaj, apartament me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, të lirohet nga bllokimi regjistruar në favor të Credins Bank.

**Intesa SanPaolo Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.05.2023, ka konfirmuar se Ervin Hodaj, V. H dhe B. H, në datë 31.12.2007, kanë pasur depozitë me gjendje 500, 000 lekë (mbyllur në vitin 2009). Gjithashtu konfirmon se në datë 29.05.2013, në llogarinë e Iris Hodaj, është transferuar një shumë prej 661, 673 lekë, me *përshkrimin* “H. S te Iris Hodaj”, Vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 07.12.2012, nr. vendimi \*\*\*, datë 25.02.2013”.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se depozita prej 500, 000 lekë, është krijuar nga kursimet e të gjithë anëtareve të familjes së tij. Kjo shumë, pas tërheqjes është përdorur për nevojat familjare. Ndërsa për shumën e transferuar në llogarinë e bashkëshortes nga halla e saj H. S, më datë 29.05.2013, subjekti sqaroi se kjo transfertë është bërë referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. Akti \*\*\* dhe nr. Vendimi \*\*\*, të datës 24.04.2013, për kujdestarinë e djalit të hallës, B. S, për të cilin ka dhënë shpjegime më lart.

#### **Bashkëlidhur paraqiti:**

- Mandat transferte në Intesa San Paolo Bank, datë 29.05.2013, i shumës 661, 673 lekë, me përshkrimin “*H. S te Iris Hodaj*”,
- Vendim Gjykate nr. \*\*\*, datë 07.12.2012, nr. Vendimi \*\*\*, datë 25.02.2013”.

Sa i përket depozitës prej 500, 000 lekë në datë 31.12.2007, evidentohet se më datë 06.04.2009, babai i subjektit V. H, ka tërhequr nga llogaria në lekë pranë Intesa Sanpaolo Bank, shumën 528, 505.34 lekë.

**AK Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, konfirmon se shtetasi i quajtur Ervin Hodaj, jo klient i AK Invest, ka kryer dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Zvicra dhe Greqia. Gjithashtu konfirmon se shtetasi i quajtur Enea Hodaj, jo klient i AK Invest, ka kryer dërgesa jashtë territorit të Shqipërisë, nga Greqia.

Administruar shkresa nga AK invest, nr. \*\*\*, datë 17.06.2020, ku konfirmohet se në datë 23.01.2014, Ervin Hodaj ka kryer transaksion (konvertim valutor), të shumës 16, 000 cad në shumën 14, 284 usd. **Bashkëlidhur:** Kopje ID e shtetasit Ervin Hodaj.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se në muajin janar 2014, në një zyrë të këmbimit valutor përballë Muzeut Kombëtar, Tiranë ka bërë një këmbim të një shume 16.000 cad. Kjo shumë ishte sjellë nga Kanadaja nga vjehri dhe vjehrra A. D dhe F. D, të cilët kërkonin ti këmbenin për shpenzimet e tyre mujore, si dhe për të paguar këstin e radhës të banesës së tyre, sipas kontratës së porosisë me firmën “K\*\*\*a” nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.04.2013. Për shkak të moshës së tyre të thyer, dhe shumës së konsiderueshme të parave, kanë kërkuar ndihmën e tij për ti dërguar te zyra e këmbimit valutor. Meqë shuma ishte e madhe, punonjësi aty ka kërkuar një dokument identifikimi, dhe në mungesë të kartave të identitetit të tyre, kam paraqitur kartën time të identitetit.

Këtë shumë e kanë sjellë vetë ata nga Kanadaja, në datë 29.11.2013, pas qëndrimit të tyre disa mujor tek vajza e tyre E. D, shtetase kanadeze me profesion mjekë, e cila ka investuar për blerjen e banesës së tyre. Edhe prindërit e bashkëshortes janë shtetas kanadez dhe shkojnë çdo vit në Kanada për një periudhë disa mujore, madje F. D ka qenë e punësuar si mirëmbajtëse zyre në spitalin “So\*\*\*\*e Re\*\*\*\*al He\*\*\*\*h Ce\*\*\*\*r” në Toronto, Kanada. Aktualisht trajtohet me pension nga shteti kanadez, ashtu siç është trajtuar dhe bashkëshorti i saj deri në kohën kur ndërroi jetë. Përveç rastit të përmendur më lart, ku ka bërë thjesht një këmbim valutor për llogari të vjehrit dhe vjehrrës, nuk ka kryer asnjë rast të dërgesave jashtë territorit të Shqipërisë nga Zvicra dhe Greqia. Subjekti shpjegon gjithashtu se as djali i tij nuk ka bërë transfertë të tilla, aktualisht djali është 16 vjeç. Bashkëlidhur dokumente për burimet financiare të vjehrit dhe vajzës së tyre. (si më lart).

Është administruar: Kontratë porosie, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 18.04.2013, për apartament me sip. 83, 5 m<sup>2</sup>, në Tiranë. Porositës: A. D. I porositor: shoqëria “K\*\*\*a”. Çmimi: 81, 900 euro, ku 35, 000 euro do të paguhen me hartimin e kontratës, 21, 900 euro do të paguhen në qershor të vitit 2014, 22, 000 euro deri në 31 janar 2015 dhe diferenca prej 3, 000 euro në momentin e hipotekimit.

**Raiffeisen Bank**, ne shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se si adresë të klientit Iris Deliallisi (Hodaj), ka të regjistruar: “Unaza e Re, Shk. \*\*\*, Ap.\*\*\*, Tiranë.

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Ervin Hodaj ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: rr. “P. K”, Nd. \*\*\*, H.\*\*\*, Ap. \*\*\*, Njësia Administrative nr. 5, 1022, Tiranë, si dhe adresën e plotë ku banon: rr. “H. K”, P. \*\*\*, Ap. \*\*\*, Njësia Administrative nr. 5, 1022, Tiranë.

**Në procesverbalin e datës 27.09.2023**, subjekti deklaroi se llogaria e parë bankare në Raiffeisen Bank për bashkëshorten, është hapur nga institucioni ku ajo ka qenë e punësuar, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, që në vitin 2004. Adresa “Unaza e re” Shk.\*\*\*, Ap.\*\*\*. nuk është në Tiranë, por në Shijak, ku bashkëshortja ka pasur banimin para martesës.

Bashkëlidhur hipoteka e shtëpisë që prindërit e saj kanë pasur në Shijak.

**QKB**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizik, apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Ervin Hodaj dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

**Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

**Regjistri Noterial Shqiptar, Ministria e Drejtësisë**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 15.09.2023, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH, për periudhën 01.03.2013 deri në datën 12.09.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për subjektin dhe personat e lidhur me të.

Nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga institucioni përkatës, ka rezultuar se konfirmohen të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, gjatë periudhës 2013 – 2023.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues për sa konfirmuar nga Raiffeisen dhe Credins Bank.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues për sa konfirmuar nga Intesa SanPaolo Bank.*
- *Sa i përket depozitës prej 500, 000 lekë e krijuar me kursimet familjare të subjektit, është krijuar në vitin 2007, dhe ndodhur në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, Trupa e Vlerësimit nuk i është nënshtruar procedurave hetimore me qëllim konstatimin e faktit nëse subjekti i vlerësimit e justifikon apo jo ligjshmërinë e burimit të krijimit për këtë llogari.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues për veprimet e kryera prej tij pranë AK Invest. Për sa konfirmuar nga ky institucion, për transaksione të kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, subjekti deklaroi se veprimet e konfirmuara nuk i përkasin atij dhe djalit të tij.*

- **Subjekti dha shpjegime lidhur me adresën e konfirmuar nga Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortes.**

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në këto elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit që konsiston në:
  - verifikimin e informacioneve në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
  - identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale;
  - analizimin dhe kryqëzimin e dokumentacionit të administruar, me deklaratimet e subjektit të vlerësimit.

## **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

**Në deklaratën e kontrollit të figurës, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se:**

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshortja, fëmijët, si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- Nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga ç'rregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

### **Procedura verifikuese**

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe 37, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

**Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 05.06.2023, nr. \*\*\*, prot., datë 06.06.2023, bën me dije se:

Në aktin e lindjes nr. \*\*, datë 24.06.1976 dhe në regjistrin themeltar të regjistrimit të popullsisë së vitit 1974, të administruar nga Zyra e Gjendjes Civile e ish Komunës Qendër Tepelenë, rezulton rubrika e mbiemrit “Hoda”. Me transferimin e tij në Zyrën e Gjendjes Civile Paskuqan, Tiranë, rezulton me mbiemrin “Hodaj”, përbërës me të cilin rezulton edhe aktualisht, për të cilin nuk ka shënime lidhur me korigjimin/ndryshimin e tij.

**Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresë \*\*\*, prot., datë 19.05.2023, nr. \*\*\*, prot., datë 02.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

**Institucionet Ligjzbatuese** me shkresat nr. \*\*\*, prot datë 25.05.2023, nr. \*\*\*, prot datë 30.05.2023, nr. \*\*\*, prot., datë 08.06.2023, informojnë se subjekti i vlerësimit Z. Ervin Hodaj:

- Nuk figuron i evidentuar për veprimtari kriminale që çënojnë sigurinë kombëtare,
- Nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen në aktivitete të kundërligjshme,
- Nuk ka asnjë informacion apo indice, që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cënim të figurës;
- Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale, apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

**Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 31.05.2023 dhe nr. \*\*\*, prot., datë 15.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

**Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore**, me shkresat e datës 13.06.2023, shkresën nr. \*\*\*, datë 21.06.2023, dhe shkresën nr. \*\*\*, datë 26.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm, nuk ka procedime penale të referuara, nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

**Institucioni Ligjzbatues** me shkresë nr.\*\*\*, prot., datë 26.07.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal,
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim, sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale,
- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale,
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 13.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se:

- Është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”, datë lëshimi 11.04.2023, e vlefshme deri më datë 10.04.2028.



- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shtete dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

**Avokati i Popullit** me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku, në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ervin Hodaj, bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri më datë 2 Korrik 1991.

#### **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 05.12.2023, protokolluar me nr. \*\*\*, prot., datë 06.12.2023, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. \*\*\*, datë 04.12.2023 për subjektin e vlerësimit Ervin Veli Hodaj.
- Deklaratë Eksperti

***Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:***

- ***Subjekti vlerësimit Z. Ervin Hodaj, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.***

#### **Denoncimet nga publiku**

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin/veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.

#### **Konkluzion:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës,

analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, arriti në konkluzionin se:

- *Në lidhje me ndryshimin e mbiemrit nga “HODA” në “HODAJ”, sipas relatimit të Gjendjes Civile, ka ndodhur në momentin e transferimit në Zyrën e Gjendjes Civile Paskuqan Tiranë, në vitin 1996, periudhë në të cilin aplikanti ka qenë në moshën 20 vjeçare. Në regjistrin e Gjendjes Civile nuk rezulton të ketë shënime në lidhje me korrigjimin/ndryshimin e mbiemrit,*
- *Vlerësojmë se, fakti i mësipërm nuk kategorizohet tek përcaktimet e nenit 42, pika 3, germa “a”, për deklaram të rremë në formularin e kontrollit të figurës, nga subjekti Z. Ervin Hodaj.*
- *Nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur,*
- *Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike,*
- *Informacionet e ardhura nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklaramin e subjektit.*

## **C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në këto elemente:
  - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
  - Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
  - Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit, e cila konsiston në analizimin dhe kryqëzimin e informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, me deklaramin e subjektit të vlerësimit.

### **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

Në formularin e aftësive profesionale subjekti deklaron:

#### **Të dhëna për Arsimimin**

- Arsim i Lartë Policor, Akademia e Rendit Publik, Viti 1996 – 1999.
- Fakulteti \*\*\* University dega “Drejtësi”, Diplomë e Nivelit të Parë, Viti 2011 – 2013.
- Universiteti i Vlorës, Master Profesional në “E drejtë penale”, Viti 2017 – 2019.

## **Procedura e vlerësimit:**

Subjekti i Vlerësimit ka filluar studimet pranë Akademisë së Rendit Publik (me shkëputje nga puna), në datë 01.09.1996 dhe i ka përfunduar në datë 01.08.1999. Në përfundim, institucioni arsimor përkatës, e ka titulluar “Specialist i lartë policie”, duke u pajisur me diplomën nr. \*\*\*.

Në Universitetin “\*\*\* University” Tiranë, ka studiuar degën “Drejtësi”, niveli “Bachelor”, në vitin 2011 deri në vitin 2013, duke u diplomuar me Vendim nr. \*\*\*, datë 02.07.2013 pranë këtij Universiteti.

Gjithashtu subjekti i vlerësimit ka studiuar pranë Universitetit të Vlorës, duke kryer Master Profesional dega “E drejtë Penale”, më datë 15.10.2017 deri më datë 20.03.2019. Në përfundim të studimeve, është pajisur me diplomën përkatëse.

*Sipas legjislacionit për Policinë e Shtetit ndër vite dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*

### **Të dhëna për Punësimin dhe ecuria në karrierë**

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Neni 45, pika 2, shkronja (dh), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve etj., të cilat janë marrë në analizë nga Trupa e Vlerësimit, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit, konkretisht:

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 27.04.2017, për Drejtues Ervin Veli Hodaj, me detyrë Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Shef Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Kurrikulave, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 19.05.2022, për Drejtues Ervin Veli Hodaj, me detyrë Shef Sektori në Sektorin e Planifikimit dhe Kurrikulave, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit, në Akademinë e Sigurisë, i shpallur fitues dhe përfunduar trajnimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, i jepet grada policore “Drejtues i Parë” dhe për nevoja pune, të*

*transferohet dhe të emërohet në detyrë profesor në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit në Akademinë e Sigurisë.*

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 09.12.2022, për Drejtuesin e Parë Ervin Veli Hodaj, me detyrë profesor në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit në Akademinë e Sigurisë, për ndryshim të strukturës organike, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Lektor, në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 16.12.2022, për Drejtuesin e Parë Ervin Veli Hodaj, me detyrë profesor në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit në Akademinë e Sigurisë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.*

Në formularin e aftësive profesionale, plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

Nga data 28.04.2017 – 22.05.2022, subjekti i vlerësimit Z. Ervin Hodaj ka ushtruar funksionin si Shef Sektori, në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit, në Akademinë e Sigurisë, emëruar me Urdhër nr. \*\*\*, datë 27.04.2017.

Nga data 23.05.2022 – 12.12.2022, subjekti i vlerësimit ka ushtruar funksionin si profesor, në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Akademinë e Sigurisë, emëruar me Urdhër nr. \*\*\*, datë 19.05.2022.

Nga data 13.12.2022 – 16.12.2022, subjekti i vlerësimit ka ushtruar funksionin si lektor, në Departamentin e Formimit të Vazhdueshëm, në Akademinë e Sigurisë, emëruar me Urdhër nr. \*\*\*, datë 09.12.2022.

Nga data 17.12.2022 – 11.10.2023, subjekti i vlerësimit ka ushtruar funksionin si Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, emëruar me Urdhër nr. \*\*\*, datë 16.12.2022.

Nga data 12.10.2023 dhe aktualisht, subjekti i vlerësimit ushtron funksionin si Drejtor, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, emëruar me Urdhër nr. \*\*\*, datë 11.10.2023.

Sa i përket dhënies së gradës policore, nga “Drejtues” në “Drejtues i Parë”, me Urdhër nr. \*\*\*, datë 19.05.2022, Trupa e Vlerësimit mori në analizë kuadrin ligjor përkatës në kohën e veprimit të tij dhe dokumentacionin e administruar nga dosja personale, e konkretisht:

- *Shkresë nr. \*\*\*, datë 04.05.2022 “Dërgojmë procesverbalin e provim certifikimin për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” në Akademinë e Sigurisë.*
- *Propozimin e Akademisë së Sigurisë nr. 1008, datë 13.05.2022.*
- *Urdhër nr. \*\*\*, datë 19.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku përmendet se Drejtues Ervin Veli Hodaj i jepet grada policore “Drejtues i Parë”.*
- *Urdhër nr. \*\*\*, datë 22.04.2022 “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për dhënie grade të aplikantëve fitues për fitimin e gradës policore “Drejtues i Parë”.*

Sa më sipër rezulton:

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, është miratuar VKM nr. 892, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, dhe VKM nr. 531, datë 29.07.2022, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, ku përcaktohen funksionet korresponduese për çdo gradë si dhe ekuivalentimin e tyre. Po ashtu është miratuar edhe VKM nr. 750, datë 16.09.2015, që miratonte Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit. Sipas kësaj rregulloreje, e cila zbatonte Ligjin e ri të Policisë së Shtetit, si dhe ndër të tjera rregullat e marrëdhënies së punës, që nga rekrutimi i punonjësve të Policisë së Shtetit, trajnimin në shkollën bazë të Policisë së Shtetit, ecurinë në karrierë, në gradë etj, Trupa e Vlerësimit gjen të bazuar sipas dispozitës ligjore që përcakton kjo rregullore specifikisht se :

“Neni 161/1”, pika 1, “Kriteret për aplikim për gradimin e radhës”, i Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015 përcakton se:

Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës), jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
- b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
- c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
- d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

“Neni 161/2”, pika 1, “Afatet e qëndrimit në gradë” përcakton se:

Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

- a) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;
- b) nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;
- c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;
- ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;
- d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;
- dh) nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

Në VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohen funksionet që i korrespondojnë gradat përkatëse.

Bazuar në këto përcaktime, Trupa e Vlerësimit konstaton se, subjekti ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 161/1, të VKM nr. 750, datë 16.09.2015, me qëllim aplikimin për gradën nga “Drejtues” në “Drejtues i Parë”.

Subjekti i Vlerësimit Z. Ervin Hodaj, ka aplikuar për gradën e rradhës duke plotësuar afatet e qëndrimit në gradë, konkretisht 8 vite (2014 – 2022).

Grada “Drejtues”, korrespondon me funksionet që subjekti i vlerësimit ka ushtruar në Akademinë e Sigurisë, për periudhën 2017 – 2022, sipas përcaktimeve të VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “*Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit*”.

Grada “Drejtues i Parë”, korrespondon me funksionin që subjekti i vlerësimit ka ushtruar në periudhën kur ka qenë me detyrë Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe funksionin aktual si Drejtor Drejtorie, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 531, datë 29.07.2022 “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të policisë së shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit*”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 27.4.2023 “*Për disa ndryshime në vendimin nr. 531, datë 29.7.2022, të Këshillit të ministrave, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin “Për gradat në Policinë e Shtetit”*”.

### **Konkluzion:**

- *Lidhur me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Ervin Hodaj, arrijmë në konkluzion se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfutuar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*

### **Vlerësimet e punës**

Në aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se gjatë 5 viteve të fundit 2018 - 2013, janë të administruara 5 vlerësime të aftësive individuale të subjektit të vlerësimit Z. Ervin Hodaj, konkretisht:

- Për vitin 2018, është vlerësuar me 27 pikë;
- Për vitin 2019, është vlerësuar me 27 pikë;
- Për vitin 2020, është vlerësuar me 27 pikë;
- Për vitin 2021, është vlerësuar me 28 pikë.

### **Konkluzion:**

- *Nga analizimi i vlerësimeve të mësipërme, konstatohet se për periudhën 2018 – 2021, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë pothuajse me pikët maksimale, (27 pikë nga 28 total).*
- *Nga verifikimet, ka rezultuar se për vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, konfirmuar më shkresën e dërguar nga DPPSH me nr. \*\*\*, prot datë 10.08.2023.*

### **Përmbushja e detyrave të kryera dhe respektimi i rregullave të etikës**

Sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, neni 43, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi.

Gjithashtu në nenin 45, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se aftësitë profesionale të punonjësit, vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Nga verifikimi i dosjes së personelit si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 2018 – 2023, subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

### **Konkluzion:**

*Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

### **Kualifikimet dhe trajnimet:**

Nga verifikimi i dosjes së personelit të subjektit të vlerësimit Z. Ervin Veli Hodaj, si dhe formularit të aftësive profesionale të plotësuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit konkretisht:

- ✓ Certifikatë për pjesëmarrjen në kurs kompjuteri për programet Windows 95, 97, Excel, Access në vitin 2000.
- ✓ Certifikatë trajnimi, marrë në vitin 2014, me objekt “Drejtim, Udhëheqësi dhe zbatim praktik”.
- ✓ Certifikatë për pjesëmarrjen në kursin bazë për hetimin e krimeve në vitin 2001.
- ✓ Certifikatë trajnimi, marrë në vitin 2003 me objekt “Krimi i organizuar”.
- ✓ Certifikatë për pjesëmarrjen në modulën “Drejtues niveli ekzekutiv, menaxhimi planifikimi strategjik”, Viti 2014.
- ✓ Certifikatë me rastin e shkollimit për nivelin e mesëm grada “Drejtues”. Viti 2014.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Standardet evropiane të kërkimit shkencor”. Viti 2017.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Policia dhe Media”. Viti 2004.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Agjentët kundër krimit”. Viti 2008.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Formim instruktori”. Viti 2008.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Agjentët në mbulim”. Viti 2008.

- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Teknikat e fshehta”. Viti 2008.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Drogerat dhe ekipi luftarak i Roterdamit”. Viti 2009.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Policia e udhëhequr nga inteligjenca”. Viti 2010.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Hetimi i përbashkët ndërkombëtar dhe ekstradimi i kontrolluar”. Viti 2011.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Njohuri mbi sistemin Patriarch Memex”. Viti 2011.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Menaxhimi i riskut për burimet e fshehta njerëzore të informacionit”. Viti 2012.
- ✓ Certifikatë trajnimi, me objekt “Informimi dhe privatësia”. Viti 2017.

Bazuar në nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, përcaktohet se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Në nenin 45 pika 2, përcaktohet objekti i vlerësimit të aftësive profesionale, ku një ndër to shërbejnë dhe certifikatat e trajnimeve.

*Nga verifikimi i dosjes personale të subjektit Z. Ervin Hodaj, konstatohet se në 5 vitet e fundit, subjekti i vlerësimit nuk është caktuar për kryerjen e ndonjë trajnimi, por rezulton se gjatë gjithë karrierës së tij si punonjës policie, ka kryer mjaftueshëm trajnime me qëllim kualifikimin për funksionin që mban.*

### **Konkluzion përfundimtar:**

Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit lidhur me vlerësimin profesional arrihet në konkluzionin se:

- *Subjekti i vlerësimit, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*
- *Funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfutuar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Për periudhën 2018 – 2021, subjekti i vlerësimit është vlerësuar pozitivisht nga eprori i drejtpërdrejtë.*
- *Për vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*



## KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Ervin Veli Hodaj, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

## PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar,

## VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Ervin Veli Hodaj**, me detyrë Drejtor, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall sot datë 25.01.2024, në Tiranë.*

## TRUPA E VLERËSIMIT

**KRYESUESE**

**Bora VRENJO**

**RELATOR**

**Henri NAQELLARI**

**ANËTARE**

**Loreta HANXHARI**

***Aneksi 1: Analiza financiare për subjektin e vlerësimit Ervin Hodaj dhe bashkëshorten Iris Hodaj***

Burimi/Vitë	17.09.2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	01.03.2023
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punësimit	480,387	1,166,068	1,376,041	1,501,243	1,442,028	1,638,658	1,697,880	1,647,850	2,312,482	2,533,918	1,964,590	1,964,060	2,244,138	2,023,990	1,959,817	2,058,129	330,538
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme		369,990						280,000		1,620,000							
Të ardhura të papërmendura më sipër							661,673										
<b>Totali i të Ardhurave neto</b>	<b>480,387</b>	<b>1,536,058</b>	<b>1,376,041</b>	<b>1,501,243</b>	<b>1,442,028</b>	<b>1,638,658</b>	<b>2,359,553</b>	<b>1,927,850</b>	<b>2,312,482</b>	<b>4,153,918</b>	<b>1,964,590</b>	<b>1,964,060</b>	<b>2,244,138</b>	<b>2,023,990</b>	<b>1,959,817</b>	<b>2,058,129</b>	<b>330,538</b>
<b>Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim</b>																	
Shpenzime jetike sipas INSTAT	176,796	409,860	639,756	853,008	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	898,380	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,138,608	1,188,144	297,036
Shpenzime per Qera													133,900	137,900	8,540		
Shpenzime për Mjekim																	
Shpenzime për Arsimitim					55,000	55,000		99,000	154,000	265,149	245,876	241,250	347,500	319,000	262,800	254,600	
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit															110,700	24,600	
Detyrime Kredite Bankare Leasing, etj									96,948	290,844	668,225						
Shpenzime dhe te dala te tjera.									524,915	670,713	335,402	158,148	51,214	140,610	93,682	449,069	
<b>Totali i shpenzimeve dhe te dalave</b>	<b>176,796</b>	<b>409,860</b>	<b>639,756</b>	<b>853,008</b>	<b>908,008</b>	<b>613,192</b>	<b>558,192</b>	<b>1,043,568</b>	<b>1,729,347</b>	<b>2,209,446</b>	<b>2,147,983</b>	<b>1,428,266</b>	<b>1,639,806</b>	<b>1,716,210</b>	<b>1,614,330</b>	<b>1,916,413</b>	
Investime,pasuri		400,000	394,656			300,000	134,400		300,000	474,500		61,000		53,077		44,989	697,590
Likuiditete																	
Gjendje Cash																	307,500
<b>Totali Pasuri</b>	<b>-</b>	<b>400,000</b>	<b>394,656</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>300,000</b>	<b>134,400</b>	<b>-</b>	<b>300,000</b>	<b>474,500</b>	<b>-</b>	<b>61,000</b>	<b>-</b>	<b>53,077</b>	<b>-</b>	<b>44,989</b>	
<b>Mundësia per Kursime</b>	<b>303,591</b>	<b>1,029,789</b>	<b>1,371,418</b>	<b>2,019,633</b>	<b>2,533,673</b>	<b>3,279,139</b>	<b>4,946,100</b>	<b>5,830,382</b>	<b>6,113,517</b>	<b>7,583,489</b>	<b>7,400,096</b>	<b>7,874,890</b>	<b>8,479,222</b>	<b>8,733,925</b>	<b>9,079,412</b>	<b>9,176,139</b>	<b>9,506,677</b>